

GUNNAR SVANE

SI TË LEXOJMË VEPRËN E BUDIT “SPECULUM CONFESSIONIS”?*

VII.

Në përgjithësi, shqipja është një gjuhë pa bashkëtingëllore geminate¹. Duke pasur parasysh këtë fakt është e habitshme të shohim mbushullimin e madh të bashkëtingëlloreve dyfishe në çdo faqe të librit të parë të Budit, *Dottrina Christiana* të vitit 1618. Nga një pikëpamje thjesht gjuhësore këto grafi dyfishe janë pa asnjë lloj interesi, duke qenë vetëm një trill i modës tipografike. Ne nuk mund ta dimë me siguri nëse ky lloj pseudogeminacioni i detyrohet vetë autorit apo tipografëve romanë. Por çfarëdo që të jetë, nuk ka dyshim se modeli ka qenë drejtshkrimi italian, në të cilin bashkëtingëlloret dyfishe ishin dhe janë ende tejet të shpeshta; ato shërbejnë për të treguar geminacionet e shumta në atë gjuhë. Për njerëzit e asaj kohe, që ishin mësuar të shihnin më tepër tekste italiane (dhe latine), çdo material i shtypur pa bashkëtingëllore dyfishe mund të jetë dukur pas gjase krejt jonormal. Mund të hamendësohet se ata, dmth. tipografët e Budit, donin ta vinin në vend këtë çudi duke futur në tekstin shqip të DC një numër të madh pseudogeminatash të cilat i bazonin në parime që sot nuk janë të qarta dhe në të cilat nuk do të hyjmë këtu. Edhe *Meshari* i Buzukut qysh në vitin 1555 përmbante shumë bashkëtingëllore dyfishe pa një geminacion gjegjës në shqipe; dhe ky drejtshkrim i frymëzuar nga italishtja erdhi e u bë kaq i qëndrueshëm sa që ende vazhdon të përdorej në shekullin XIX.

Dhe në fakt është e çuditshme të shohim se si *Speculum Confessionis* i vitit 1621 thuajse i ka shmangur tërësisht dyfishimet zbukuruese të bashkëtingëlloreve. Kjo vështirë t'i detyrohet rrethanës që shtypshkronja tashmë ishte marrë në pronësi nga trashëgimtari i Zanettit, sepse tipografët romanë ndërkohë zor se kishin marrë mundimin të mësonin shqipen. Ne do të prisnim prej tyre të ishin po aq të varur nga shkrimi dhe leximi italisht si në vitin 1618, dhe prandaj të prirur për të shtypur bashkëtingëllore dyfishe edhe në

* Përkthim nga origjinali anglisht “How to read Budi’s ‘Speculum Confessionis’?”, *Studia Albanica*, nr. 1, 1980, f. 121-179. Në këtë numër është paraqitur pjesa e dytë e artikullit, f. 150-179 e origjinalit.

¹ Për geminacionin në shqipen e sotme, khs. Çabej, 1976³, f. 143.

tekstin shqip të 1621-shit. Fakti që pseudogeminacioni u hoq nga SC mund t'i detyrohet një ndërhyrjeje të ndërgjegjshme nga ana e Budit, ose gjatë përgatitjes së dorëshkrimit prej tij ose ndoshta më vonë, gjatë bisedimeve me shtypshkronjën. Është vërtet e shënueshme që Budi, i cili e njihte mirë kodin drejtshkrimor të italishtes dhe në shumë pika të tjera e bazoi mënyrën e shkrimit të tij në normat italiane, tani e shkeli këtë traditë. Por ai kështu veproi. Për më tepër, duhet të mendojmë se Budi kishte një kuptim të qartë të faktit se shqipja nuk kishte bashkëtingëllore geminate të mirëfillta dhe prandaj duhet të shmangte shkrimin e bashkëtingëlloreve dyfishe.

Por e gjithë kjo nuk do të thotë se nuk ka shkronja bashkëtingëllore dyfishe në SC. Përkundrazi. Mirëpo ato zakonisht përdoren për qëllime të tjera nga ato të geminacionit dhe duhen trajtuar veçan.

Në SC gjejmë një numër gabimesh shtypi, që janë krejt të zakonshme – p.sh. *ccrpit* 329.12 në vend të *corpit* (*korpit*), *ooçççij* 200.27 në vend të *ooççij* (*oo thii*), *ttneot* 259.28 (*Tinëzot*). Ka shembuj të ndryshëm geminacioni fals, që nuk i përgjigjen ndonjë realiteti gjuhësor – si: *eteffestevet* 327.14 (*e të festëvet*), *emmaatepere* 69.16 (*e maa tepërë*), *mbete rref8emmit* 312.4 (*mbë të rrefyemit*), *ippafati* 198.19 (*i paafati*), *pas funiteet8ne* 43.7 (*pasunitë e tyne*). Por duke pasur parasysh se SC është një vëllim i madh prej më se 400 faqesh të shtypura ngjeshur, ai përmban shumë pak relike të këtij drejtshkrimi tradicional.

Nga ana tjetër ka disa bashkëtingëllore dyfishe që duhet të jenë aty pasi kanë një funksion të veçantë. Grupi *shk* shkruhet *fcc*: *fccuom* (*shkuom*), *fccambi* 41.20 (*shkambi*), *tachifccaa* 381.22 (*ta qish kaa*). Në mënyrë të ngjashme *shq* është shkruar *fcch(i)*: *fcchife* 61.18 (*shqise*), *meeufscch8em* 235.21 (*me e ushqyem*), *mpfscchielm* 235.6 (*mpshqelm*). Grupi *çk* jepet rregullisht si *cc*: *ccaçççete* 156.29 (*çkathëtë*), *eccu/cellohene* 147.2 (*e çkushëllohenë*), *cckallemuom* 140.5, *ecckalemuom* 203.27 ((*e*) *çkallëmuom*), *icckulle* 163.14, *eccule* 163.18 (*i/e çkulë*), *emeccarcuom* 222.30 (*e me çkarkuom*) etj. Grafia *zz* duket të qëndrojë për *xh* në *gniayzzuçiu* 189.6 (*njaj xhudhiu*); kjo fjalë përgjithësisht shkruhet *giuçij*, – ndoshta edhe te *zzgieçe* 152.10. Nuk është shumë e qartë çfarë do të thotë ajo në fjalë si *zzakeut* 170.15, *ezzekeillit* 334.29. Këtij problemi do t'i kthehemi më vonë.

Edhe në rastet kur mund të pritej një bashkëtingëllore dyfishe, Budi përdor vetëm një. Kombinimi *ss* asimilohet në *s*: *mbafi* (*mbasi*) është trajta e zakonshme e asaj që deri vonë shpesh shkruhej etimologjikisht si *mbassi*. Asimilimi ndodh madje edhe në fjalë të huaja kur do të pritej ruajtja e italishtes *ss*: *Confefinaar* [3.17] (*konfesionaar*; me gabim shtypi), *confezione* 155.29, *Procezione* 302.21.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar grafisë *tt*. Përsëri hasim një grafi me *tt* pa ndonjë substancë gjuhësore në të: *iduhette* 41.28 (*i duhetë*), *gniffete* 51.7 (*njifetë*), *fmundekiette* 201.22 (*smunë kietë*), *tekiette* 291.17 (*të kietë*), e

forma të tjera foljore të ngjashme. Më tej: *Terijtte* [1.25] (*të riitë*), *teparatte* 125.13-14 (*të paratë*), *ete d88tatte* 125.16 (*e të dyyjtatë*), *plotte* 297.14 (*plotë*), *yette* 36.4 (*jetë*), *Margallittaar* 209.11 (*margal(l)itaar*).

Përsëri ka raste ku ndeshim *tt* në kontekste ku duhet të prisnim një geminacion origjinal: *forttue* 178.18 (*fort tue*). Gjithsesi, kjo duket të jetë fort e pagjasë, duke marrë parasysh shembujt e shumtë me asimilim: *maaforte deeyene* 111.19 (*maa fortë* (< *fort të*) *deejënë*), *forta fctyere ndemend* 161.28 (*fort a* (< *fort t a*) *shtjerë ndë mend*), *forti ncelgnie /88te* 291.15 (*fort i* (< *fort t i*) *nçelnjë sytë*). Prania e kësaj *t-je* të gjuhës së folur si përfaqësuese e një *tt-je* që qëndron në bazë të saj është shumë e rëndësishme për identifikimin e trajtave të shquara emërore më *-t* të ndjekura nga nyja konektive *të*. Tipi lokativ *mbë malt të lartë* është tepër i zakonshtëm në tekstin e Budit dhe ndërtime të këtij lloji tërheqin vëmendjen vazhdimisht gjatë leximit të SC, sepse *-t-ja* bazike është shkruar gjithmonë *-te*. Një ndërtim si *mbedite Diell etefeftevet* 111.25 natyrisht që duhet shqiptuar *mbë ditë diell e të festëvet*; por *ditë* pa dyshim është asimiluar nga *dit* (shumës) + *të* (nyje konektive; khs. *të përpara festëvet*) – ose edhe *dit-t* (lokativ) + *të*.

Fjala italishte *legittimo* me një *tt* geminate jepet si *feyanelegitim* (*se janë legjitim*) në 42.20.

Kombinimi *dt* është shumë i rrallë: *ndiere ndecandt* 1.23 (*ndjerë ndë kandt*; lokativ). Por çfarë është shkruar këtu si *dt*, pas gjithë gjasash ka qenë shqiptuar *tt* ose më fort *t*, për të cilën kemi prova të ndryshme të një zinxhiri asimilimi *dt > tt > t*. Shembulli i cituar më lart ka një paralele *ndiere nde cant* 135.23. fjala *calcind* “kelshenjt” (gjinore e shquar: *calcindit* 135.9) ka trajtën e lokativit *ndecalcint* 134.16. Fjalët *vend të* “në vend të” janë shkruar *vente* gjatë gjithë librit, dhe ky ka qenë pa dyshim shqiptimi i vërtetë. Fjala *gazimente* (< *gazimend të*) ka në bazë fjalën *gazimend*, dhe p.sh. *mentane* (< *mend tanë*) ka në bazë *mend*. Ndoshta edhe prapa shembujve të mëposhtëm fshihen trajta të lokativit, p.sh. *nde mendtande* 151.28 (*ndë men[dt] tande*), *ndementevet* 214.27 (*ndë mend[dt] të vet*). Fjalët *ndefunte* 226.28 (< *ndë fund të*) lidhen me *fund*. Fjala *grazhd* del në kombinimin *ndegraxttecaut* 265.9 (*ndë grasht* (< *grazhdt të kaut*).

Por është një gjë të identifikosh një *tt* ose *dt* të fshehur prapa grafisë, dhe një tjetër gjë ta japësh *t-në* e asimiluar në një transkriptim, pa e ndërlikuar leximin. Raste si *forttue*, *candt* janë të lehta për t’u përballuar – natyrisht ato duhet të jepen si *fort tue*, *kandt*. Por rastet e tjera të përmendura më lart janë vështirë për t’u trajtuar, në qoftë se në të njëjtën kohë duam të përmbushim kërkesat themelore të drejtshkrimit të sotëm që kufijtë e fjalës duhen shënuar nga një hapësirë. Në këtë pikë duhet t’u drejtohem konvencioneve. Të rindërtosh format bazë që qëndrojnë prapa tyre pa dyshim që do të lehtësonte të kuptuarit; por nga ana tjetër një procedurë e tillë në fakt do ta dhunonte gjuhën e Budit dhe do të jepte një përshtypje të rreme për shqiptimin e autorit. Ne do

të parapëlqenim të shkruanim p.sh. *for-të, fort-a, gazimen-të, vend-të, fun-të* etj. dhe kështu t'ia linim vizës ndarëse të tërhiqte vëmendjen në faktin se, në procesin e asimilimit, janë zhdukur një ose dy bashkëtingëllore dhëmbore.

Dy tingujt kakuminalë *r*, të cilët në drejtshkrimin e sotëm shkruhen *r* dhe *rr*, përbëjnë një çift fonemash të pavarura. Pavarësisht nga pozicioni i tyre në fjalë, ata kanë funksione dalluese, khs. çiftet minimale:

<i>reze</i>	<i>rreze</i>
<i>ara</i>	<i>arra</i>
<i>var</i>	<i>varr</i>

kundërvënia *r : rr* shpesh përcaktohet si kundërvënie midis “*r*-ja e butë/e thjeshtë” (= *r*) dhe “*r*-ja e fortë/e rrotulluar” (= *rr*); por asnjëri nga këto përkufizime tradicionale nuk është krejtësisht i saktë. Kjo kundërvënie nuk ka të bëjë aspak me palatalizimin: velarizimin (si te *l:ll*), as me kundërvënien i pazëshëm: i zëshëm (si te *t:d, q:gj, ç:xh* etj.). Foneticienët e përshkruajnë *rr*-në sikur është e nyjtuar me dyfishin e dridhjeve në krahasim me *r*-në², dhe *rr*-ja mund të quhet në mënyrë të përshtatshme *r* emfatike ose “*r*-ja e gjatë”³. Kundërvënia *r:rr* në toskërishte është neutralizuar në masë të gjerë, por është ruajtur mirë në gegërishten (dhe në standardin modern)⁴. Prandaj nuk është çudi që dallimi midis dy tingujve *r* është shënuar nga të gjithë autorët e vjetër gegë. Riprodhimi i *rr*-së me anë të shkronjave dyfishe dëshmon konceptin e tyre për tingullin si një lloj *r*-je geminate. Ky interpretim përputhet me përshkrimin e dhënë shpesh nga foneticienët e sotëm.

Asnjë nga shkrimtarët gegë të shekujve XVI dhe XVII nuk përdori një drejtshkrim krejtësisht të qëndrueshëm kur duhej bërë dallimi midis *rr* dhe *r*; megjithatë nuk ka dyshim se në tekstet e Budit shihet kujdesi më i madh për këtë. Në SC ndeshim një *r* nistore në fjalë si *ree* “rashë” (në togfjalëshin frazeologjik *ree mboh* 312.1 “mohova”⁵) – ose tek e shpeshta *ruonj* (*ruojtune* 366.17, 18; *eteruhemincofc* 367.6 (*e të ruhemi ncosh*)). Në brendësi të fjalës ka një *r* p.sh. *derdh* (gabim shtypi: *mederçuae* për *-une* 345.27), *jerm* (*yerm* 335.25), *verbën* (*verbenite* 347.4). Ka po ashtu një *r* finale në fjalë si *quor* “qilar” (*chiorit* 387.10), *shpuor* “shpor, mamuz” (e shkruar *fcpuor* 307.23). Fjala për “argjend” jepet me trajta të ndryshme për gegërishten: *rrgjânn*, *rgjânn*, *argjânn* (Bashkimi, 381). Budi shkruan *Rgiand* 143.25, *Arioorgiandi* 278.2 (*ari oo rgjandi*); me gabim shtypi *Rhiandit* 143.24. Folja “rrjep” jepet

² Shih Dodi, f. 35.

³ Shih Gjinari, f. 45.

⁴ Për hollësi, shih Gjinari, f. 45; Dodi, f. 36.

⁵ Khs. shprehjen *udariti u bah*, që ishte e zakonshme në serbokroatishten mesjetare.

edhe *rjep* edhe *rrjep* në fjalorët e sotëm standardë (Kostallari rekomandon vetëm këtë të fundit). Për gegërishten fjalori jep vetëm *rjepi* (dhe *repi*; Bashkimi, 375), dhe po ashtu Budi shkruan *eriepene* 101.12 (*e rjepënë*), *meriepune* 141.29. Fjalës së sotme *tmerr* me derivatet e saj i përgjigjet gegërishtja *tmër* (Bashkimi, 457) – dhe kjo është mënyra se si e shkruan Budi atë: *tmer8eme* 348.20, *etmeeryeze* 338.15 (*e tmeerjet së*). Fjala për “zjarr” tani është *zjarr* ose *zjerm* – në gegërishte përdoren trajtat *zjar* e *z(j)arm* (Bashkimi, 518). Budi shkruan *zjarm* (p.sh. *eyarmit* 387.28). Një formë tjetër e së njëjtës fjalë: *tfr88gnije eyarre Amefciuum* 388.18-19 është një kallëzore e shquar; në qoftë se nuk është thjesht një tjetër gabim shtypi, kjo mund të jetë një *zjar-në* e asimiluar në *zjarrë*.

Një numër i madh fjalësh në SC shkruhen rregullisht me *rr*. Këtu do të kufizohemi të japim disa prej tyre në transkriptim. Me *rr* nistore: *rrah*, *rrahat* 321.22 “lirishta pyjesh”, *rrallë*, *rrasë*, *rremb*, *rreenj*, *rreth*, *reeze*, *rrazonj*, *rrëmbyeshim*, *rrit*, *rrjedh*, *rrjetë*, *rruozë*, *rryesht*. Ka një *rr* fundore në *çporr*, *nxjerr* – dhe një *rr* në trup të fjalës në *andërrë*, *arrësye* (*rrallë arësye* që i përgjigjet së sotmes *arsye*, që jepet gjithashtu për gegërishten (Bashkimi, 26)), *askuurraaj*, *çkarërronj* (dhe *ngatërronj*), *kërrus*, *ndërronj*, *parriis*, *përraallë*, *sherrëgjii*.

Megjithatë, në disa fjalë që pa dyshim kanë pasur *rr* në gjuhën e autorit haset paqëndrueshmëri drejtshkrimore. SC në përgjithësi ka një *rr* nistore në fjalë si *rregjënii*, *rrëfyem*, *rrobë*, *rrogë*, *rryp* – por ndeshim gjithashtu grafi si *regienij* – *Ref8mit* 1.1, *pteref8em* 22.9, *ref8hete* 216.1 – *Roobefc* 153.22, *Robete* 153.24 – *rogene* 91.16 – *mber8pte* 394.28 e kështu me radhë. Ka një *rr* në trup të fjalës në fjalë si *mbaarre*, *mnërrinj*, *thërres*, dhe në shumicën e rasteve ato janë shkruar kështu. Por gjejmë edhe p.sh. *mbareye* 6.15, *stamberini* 80.12 (*s t a mbërrini*), *mberijm* 85.23, *mberij gniene* 220.28, *mbeerijm* 239.21, *tueççire* 81.26. Sidomos disa rrënjë më *rr* si *erret*, *ferri*, *marr*, *vdjerr*, *vorr* duket të prirën drejt një drejtshkrimi me *r*: *uer* 210.30 (*u err*), *as feri*, *as Parriji* 31.4-5, *mer* 91.3; 201.2, *marene* 201.6, *oondeyeuvdierte* 91.14 (*oo ndë j u vdjertë*), *voruom* 121.8 (por kallëzorja e shquar *vorrne* 42.24).

Në një numër të madh fjalësh Budi ka *rr* si një produkt i asimiluar i *rn*. Fjala *taverrë* “tavernë” përmbahet në *taverrete* 380.5, *etaverrete* 383.17. *Mbaresa -në* e vetës 3 shumësim asimilohet në aoriste me bashkëtingëlloren fundore të rrënjëve foljore: *keemuorre* 87.9 (*ke e muorrë*), *inzuorre* 314.21 (*i nxuorrë*). *Mbaresa -në* asimilohet me *-r* fundore të rrënjëve emërore për të formuar kallëzoren e shquar njëjës: *biërrë*, *hiërrë*, *vistaërrë* (por: *vorrne* 42.24, *meliciferrne* 312.21-22). Mbiemri *mpastër* (*mpastre* 42.2) ka një kallëzore të shquar *mpastërrë*: *ate giççachie tempasterre*, *ete delirene yeteneet8ne* 225.7-8.

Në një numër fjalësh të huaja ka njëfarë pasigurie në zgjedhjen e *r* apo *rr*. Emri biblik i vendit *Gomoree* (*etegomoreefe* 190.2) dhe emri i popullit *Romanjet* (dhanore shumë e shquar, shkruar *Romagniet* 349.14) janë dhënë

me *r* si *senxhirë* (shkruar *fengire* 408.10; khs. 403.15). *Aristoteli* është shkruar *Arristotilo* 306.26, kurse *Luciferi* del si *luciferri* 339.6 (*liciferri* 389.21), *luciferri* 201.11; 387.21, në kallëzore *emeliciferrne* 312.21, por *Luciferne* 247.28. Fjalët *ferratë* dhe *gverrë* (*guerrë*) janë marrë drejtpërdrejt nga italishtja (*ferrato*, *guerra*): *temarme... fcapne ooferratene ndore* 364.30-31, – *luftë egverre* 240.⁶. *Parrokiagnte* 67.28 i përgjigjet italishtes *i parrochiani*. Fjala *turrë* pas gjase është një huazim i vjetër latin: *mbe gnietevetemene Turrete babilonyefe* 245.20-21 (*mbë një të vetëmenë turrë të Babilon'jesë*); ka qenë përdorur së pari nga Buzuku (i cili shkruante *turë*)⁷.

Fjala latine *baptisterium* është një term arkitekture që shënon një ndërtesë a dhomë në të cilin kryhet shërbimi i pagëzimit. Budi e përdor fjalën në një kuptim pak të ndryshëm. Në kontekstin *Missaalle ebreviaalle, ecalendaarre* 395.20-22 (*a e kaa gjithëkush maa pak Rituale oo baptisteerrë e rii e ashtu ende misaallë e breviaallë e kalendaarrë*) kjo fjalë duhet të jetë emërtimi i një lloji libri liturgjik i krahasueshëm me mesharin, breviarin apo kalendarin – domethënë, një libër që përmban ritualin e pagëzimit. Mënyra si shprehet autori: *Rituale oo baptisteerë e rii*, mund të sugjerojë se këta dy terma kanë qenë sinonime. Në çdo rast forma me *-rrë* është një kallëzore e shquar me një asimilim. Por ndoshta nuk është krejt e qartë nëse është formuar nga një temë në *r* apo në *rr*.

Është karakteristikë e gjuhës së Budit që një numër huazimesh pas gjase të reja latino-italiane që përmbajnë një *r* nistore janë përshtatur me *rr-*. Kështu ndeshim *rrekomendonj*; *errecumendoheey* 315.13, *rrecomenduom* 249.15, – *rreligjonë*: *rreligione* 30.5, *erreligione* 41.26, *errelione* 322.15, por *religione* 43.30; 85.7, 19; – *rremedie*; *erremedie* [2.25]; – *rrenegonj*: *mete rreneguomite* 347.23, *rreneguone* 338.22, por *Reneguone* 346.29; – *rrespondonj*: *tue irrefponduom* 312.17; 313.19; – *rreverencie*: *erreverentie* 14.6; 34.9; 49.5, 11, por *reverentie* 34.27, *ereverentie* 173.8. Përgjegjëse të it. *irregolarità* në SC gjejmë: *sbie ndirregularita* 64.16, *yane raam irregularita* 126.28-29, *q/cte raam, irregularita* 129.1, por p.sh. *biendiregularita* 42.15, *yane raam iregularita* 64.25-26; 88.1-2, *eme raam iregularita* 126.1-2. Kjo lëkundje midis *bie ir(r)egularita* dhe *bie nd ir(r)egularita* sugjeron, mendojmë, se emri në fjalë është marrë nga priftërinjtë dhe është përdorur drejtpërdrejt si term teknik pa ndonjë përpjekje për t'ia përshtatur sintaksës së shqipes. Sidoqoftë, në 63.5 gjejmë: *raam ndirregularite*.

Dy tingujt *l* të shqipes: *ll* velare dhe *e* ashtuquajtura *l* palatale, nuk dalloheshin mes tyre rregullisht derisa Bogdani në fund të shekullit XVII i shkroi përkatësisht *λ* dhe *l*. Por edhe para tij autorët gegë u përpoqën t'i

⁶ Për këtë të fundit khs. *Bellum/Lufta*, ò *Guerra* në Fjalorin e Bardhit.

⁷ Për këtë fjalë, e cila nuk njihet gjetkë në latinitetin ballkanik, khs. vërejtjet etimologjike të Çabejt. Fjala nuk përmendet te Haarmann 1972.

dallonin këta tinguj në shkrim, duke i paraprirë kështu drejtshkrimin modern me disa shekuj. Përndarja e tyre në veprat e Bardhit e mbi të gjitha të Buzukut është shpesh e paqëndrueshme. As Budi nuk është krejt koherent; megjithatë, ai është njëri nga autorët e vjetër i cili e përdor *ll* më me rregullsi për tingullin e velarizuar. Natyrisht kjo grafi nuk ka të bëjë aspak me geminacionin.

Me gjithë mungesën e qëndrueshmërisë drejtshkimore, si rregull, nuk është e vështirë të identifikojmë tingujt *l* duke bërë krahasime me përdorimin e sotëm. Në disa fjalë gjejmë një grafi të paqëndrueshme. Siç pritej, folja *kallëzonj* është shkruar *calleeuom* 25.2; 371.15 (një vokalizëm i ndryshëm është përdorur në *callæuō* 16.24; 116.6, *callæon* 16.27) – por edhe p.sh. *caleuom* [9.27]. Emri *pëllas* është shkruar *Pelaſit* [3.22], por trajta e shumësit e saj është *pellife* 137.9. Folja e shpeshtë *qeell* shkruhet në mënyra të ndryshme: *chieelle* 255.25, *chiellune* 98.1, *echielliçuune* 320.11, – por *echiel zuune* 342.29. Në shumicën dërmuese të rasteve emri *qiell* është shkruar me një tregues të qartë të një *ll*-je të velarizuar: *mbechiellt* 227.5, *preychiellycit* 259.13 (gabim shtypi: - *ſcit*), – por me raste hasim edhe grafi si *efyetulleze* 145.25, – por p.sh. *syetulete* 342.14. Folja dhe derivate të tjera që i përkasin fjalës *shkandullë* në shumë raste kanë *ll*: *ifccandullizogniene* 57.21, 27, *fecandullizimte* 74.17 (gabim shtypi për: *ſccan*-), *ſcandullizim* 83.16, *pſcandullizimte* 97.29 etj., – por mund të hasen edhe grafi si *ſcandulizuom* 182.28. Budi shkruan *ccallemuom* 140.5 (*çkallëmuom*) – por edhe *eccalemuom* 203.27. Fjalë të tjera me një *ll* të velarizuar dhe me grafi të ndryshme përfshijnë p.sh. *mërekullonj*: *mereculuome* 369.9, – *sjell*: *fjelte* 226.16, – *strumbullar*: *strumbularij* 247.18, – *kallamar*: *ecalamarre* [6.23].

Në disa fjalë të huaja shqiptimi është i pasigurt. Si gjegjëse të fjalës *margaritar* të gjuhës së sotme ne gjejmë në tekstin e Budit një variant në të cilin *r*-ja e dytë me disimilim është zëvendësuar me një tingull *l*, dhe këtu autori rregullisht shkruan *margallitaar*, p.sh. 209.11, 319.1. Në SC fjala latine *breviarium* është përshtatur si *breviallt* 259.30 (lokativ), *ebreviaalle* 395.22 (kallëzore e shquar); kjo tregon një shqiptim me *ll*. Fjala latine *missale* shprehet nga *Mifalt* 182.18 (lokativ), por në 395.22 është shkruar *Mifaalle* (kallëzore e shquar); ndërsa latinishtja *sacerdotale* ka trajtën e lokativit *Sacerdotaallt* 182.18. Duke gjykuar nga konteksti, *Rituale* 395.20 duhet të ishte *rituallë* (kallëzore e shquar); pas gjase ajo përfaqëson termin latin të marrë pa ndryshuar. Në *Mesharin* e Buzukut ka një *l* palatale në emrat biblikë si *Ezekieli*, *Lazari*; të parin Budi përgjithësisht e shkruan me *ll* (p.sh. 334.29), por e dyta shkruhet *laæeri* 370.2. Shembujt *ſcendillijnee* 51.10, *Eiſcendilliu* 51.20 pas gjase riprodhojnë *shënd Illiu* të gjuhës popullore; ky drejtshkrim u zgjodh për transkriptimin e tekstit të Buzukut. Emri i Shën *Ursula*-s (i shkruar kështu si në latinisht edhe në italisht) jepet si *Vrfulle* 328.20.

Formula latine *coram populo* del dy herë në SC: *coram Popullë* 297.8, *coram populle* 394.20. Kjo mënyrë shkrimi me gjasë është ndikuar nga shqipja *popull*. It. *colazione* “vakt; drekë” jepet si *collatione* 50.8.

Në SC nuk kemi gjetur shembuj të përzierjes së *ll* e *dh* që tani është karakteristike për gegërishten veriore.

Palatalja *l* në të shumtën e rasteve shkruhet *l* në të gjitha pozicionet: *lakëmi*, *lamë*, *lypunë*, *palavii*, *dëliir*, *plotë shqelm*, *nçel* janë shembuj të një drejtshkrimi pak a shumë të qëndrueshëm.

Megjithatë hasen shmangie edhe këtu. Grupi *flas*, *flet*, *folë* / *folunë*, *fjalë* normalisht shkruhet me *l*, por në shembuj të ndryshëm gjejmë edhe lexime si p.sh. *mefyallete* 40.11, *fyalle* 40.15. Fjala *bulmet* (kështu në 91.20) shkruhet *bullmeti* 91.23. Folja *dal*, *del* (aoristi i Budit është *duol*) ka *dallene* 141.18. Fjala për “kalë”: *kalë* është shkruar *sicuurcaalijsaafree* 173.16 (*sikuur kaali i paafree*), por *caallinee zgriebete* 229.29, – khs. edhe *ncaaluor* 369.16; në shumës Budi ka *qualte* 382.23. Folja *çkul* është shkruar drejt në *eccule* 163.18, *cculene* 246.2, – por *icculle* 163.14. Fjala *lopë* del në *thithëlopë* dhe është shkruar *ççiççelopa* 317.14; 318.10 – por *ççiççellope* 316.14, 17, 29. Emri *lot* shkruhet me një *l* palatale p.sh. në *Lot* 220.6, *lotet* 231.3. – por në 302.29 ka *mellote/88vet*. Ndër variantet e tjera të shkrimit mund të përmendim *nallt* 227.5 (*nalt*), *aste vogelline* 391.30 (*as të vogëlinë*).

Në gjuhën e sotme shkalla e palatalizimit ndryshon. Përveç një *l*-je në të folme periferike arkaike, tingulli *l* nuk është aq “i butë” sa *l mouillé* e gjuhëve sllave, dhe në fakt është më i afërt me të ashtuquajturën *l* europiane. Natyrisht ne nuk dimë asgjë për vlerën e saktë fonetike të *l*-së së Budit. Folja *mbledh* në SC shkruhet me një diftong, dhe drejtshkrime si *mbelyëçune* 230.29, *meumblyëçune* 394.24-25, *mbelieçune* 394.22 sugjerojnë një shqiptim *mbëljedh* (*mbëljedh*) me një *l* që me gjasë ishte fort e palatalizuar.

Fjala e huazuar *kolegjë* në SC shkruhet *Colegiene* [2.22], por *ecollegie* 351.14; kjo e fundit mund të ketë pasur it.-lat. *collegio*, *collegium* si model.

Në gjuhën e Budit *l*-ja është zhdukur nga të gjitha format e fjalës *uk* (< *ujk*, *ulk*): *Vcu* 11.25, *ucu* 116.2 (khs. edhe 242.25; 294.5; 405.29; *uku*), – *ucut* 390.20, – *uchit* 302.27 (*uqit*), – *V chyet* 123.16, *uchiet* 255.17 (202.14) (*uqet*), – *uch/cit* 335.15 (*uqshit*). Bashkëtingëllorja ruhet në *bulchijtee* 138.9 (*bulqiitë e*), e cila i përket fjalës *bujk* (< *bulk*).

Në disa të folme të shqipes, veçanërisht në toskërishte, faringalja e shurdhët *h* artikullohet dobët dhe në disa pozicione zhduket fare. Në gegërishte kjo bashkëtingëllore është më e qëndrueshme, por edhe atje ka lëkundje në të folme të ndryshme, p.sh. në të folmen që pasqyrohet në *Mesharin* e Buzukut⁸. Budi e përdor shkronjën *h* më me kursim se Buzuku, dhe edhe një lexim i

⁸ Shih botimin e Çabejt, f. 79-91, për *h*-në si shkronjë dhe tingull te Buzuku.

shpejtë i SC tregon se drejtshkrimi i këtij teksti është shumë koherent në përdorimin e *h*-së. Pas gjase faringalja nyjëtohej qartë në të folmen individuale të Budit kështu që ai nuk kishte vështirësi në përdorimin e saktë të shkronjës *h* pavarësisht nga fakti se ajo ishte e heshtur (e pazëshme) në drejtshkrimin italian që ai imitonte. Budi shkruan rregullisht p.sh. *hapune* (*hapunë*), *here* (*herë*), *coho* (*koho*), *crahanuor* (*krahanuor*), *giuhu* (*gjuhu*), *rrahat*, *vetehe* (*vetëhe*), *duhete* (*duhetë*). Te fjala *ndime* (*ndimë*) dhe në derivatet e saj nuk ka kurrë një *h*, – dhe as në kallëzuesorët *leete* (*leetë*), *nzeete* (*nxeetë*); nga ana tjetër Budi thajse gjithmonë përdor *hore* (*horë*; në standardin e sotëm: *orë*).

Në raste të rralla *h* shënohet si *ch*, p.sh. *chelmumomeya* 318.5 (zakonisht *helmuom*).

Ndërndërimi *h ~ f* është sporadik në toskërishte por është karakteristik për shumë të folme të gegërishtes⁹. Ai është i përhapur gjerësisht në pjesën qendrore të truallit gjuhësor, mbi të gjitha në gegërishten jugore. Meqenëse e folmja e Budit pas gjase i përkiste këtij tipi qendror ose jugor, nuk është për t'u çuditur që shndërrimi *h ~ f* është shumë i shpeshtë në SC. Ai vihet re vetëm në rrënjët foljore me një *-h* fundore: *çpih*, *ftoh*, *kreh*, *leh*, *mpreh*, *msheh*, *ngroh*, *njuh*, *njuh*, *rrah*, *shoh*. Në SC ashtu si dhe në veprat e tjera Budi përdor jo vetëm format në *-h* por edhe forma si: *cpifune* 107.29, *gniofune* 77.7, *chitekrifeey* 102.27 (*qi të krifeej*), *melefune* 37.13, *tepaagniefuna* 158.11, (e shpeshtë; gabim shtypi: *paaguiefuna* 212.7), *scioffc* 240.30 (*shofsh*; lidhore, v. 2. nj.). Çabej ka analizuar vëzhgimet e tij lidhur me ndërndërrimin *h ~ f* në një syth të veçantë të studimit të tij historik mbi konsonantizmin e shqipes, dhe ka bërë krahasime midis autorëve të ndryshëm gegë¹⁰. Te Buzuku ndërndërrimi është i rrallë; Budi dhe Bogdani përdorin të dyja format në *-h* dhe *-f*; vetëm Bardhi duket të jetë i qëndrueshëm në përdorimin e *-f*-së. Nuk ka dyshim se gjuha e Budit, që siç është thënë më parë përfaqëson një varietet jugor të gegërishtes, meriton një hulumtim të hollësishëm lidhur me këtë çështje të veçantë të fonetikës historike. Një studim i tillë natyrisht duhet të marrë parasysh materialin e të gjithë veprave të tij.

Në grafinë e Budit shkronja *h* është pjesë e kombinimit *ch* por këtu nuk ka vlerë të pavarur (*ch* = *q*). Një *th* qëndron për *t* në emrin e përveçëm *Thoma* (përdorur krahas *Tomaqij*), khs. *Toma* 302.5. Aty ku *th* është një kombinim i parashtesës *t(ë)*- dhe një *h*-je pasuese, të dyja shkronjat ruajnë vlerën e tyre të pavarur: *yuthap eyu tfunduo* 320.3 (*ju u t'hap e j u tfunduo*), *euthipne* 317.21 (*e u t'hipne*), *thyekene* 48.5 (*t'hjekënë*), khs. *thiekene* 48.16, *thiecune* 79.9, 102.11, *methiecune* 96.13 e kështu me radhë¹¹.

⁹ Khs. Dodi, 47; Gjinari, 41-42.

¹⁰ Çabej, 1973², f. 195-200.

¹¹ Për parashtesën *t(ë)*- dhe *tër*-, shih Xhuvani-Çabej, 1956, nr. 72 dhe 74.

Shkronja *y* është përdorur disa herë në raste ku do të prisnim *ij*, që në SC është grafia normale për zanoren e gjatë *ii*. Rastësisht, shkronja *j* gjendet vetëm në këtë kombinim të veçantë.

Përveç kësaj parregullsie tipografike, shkronja *y* në tekstin e Budit në parim përfaqëson bashkëtingëlloren *j*. Duke shqyrtuar vokalizmin ne kemi parë se diftongu ndërbashkëtingëllor *ie* nganjëherë shkakton vështirësi në lexim dhe transkriptim, pasi ne nuk mund të jemi gjithnjë të sigurt nëse kjo mënyrë shkrimi duhet marrë si grup zanor *ie* apo si një diftong ngjitës (*je*). Huazimet e tipit *fën'jeshtërë*, *mjeshtrii*, *pjesë* me sa duket shkruhen gjithnjë me *ye*: *fene/ctre* 87.15, *mye/ctrij*, *pye/e*. Megjithatë ne jo vetëm gjejmë *tyere* për *tjerë*, por edhe *tiere*. Kjo do të thotë se bashkëtingëllorja *j* në SC shkruhet jo vetëm *y* por edhe *i*.

Një *j* në fillim të fjalës para zanoreve haset në fjalë si *yane*, *ya/cte*, *yo*, *yete* (*jetë*, e shkruar *yette* 36.4 etj.), *yeete* (*jeetë*) e të tjera si këto; – grafi alternative p.sh. *iemi* 363.15, *io* 6.8. Ka një *j* ndërzanore në trup të fjalës në *keyo* (*këjo*), *kriiyuō* (*krijuom*), *fayet*, *murtaye*, *nevoye*; – grafi alternative janë p.sh. *preinzoie* 89.15 *camfeiðem* 23.5 (por *feyeu* 308.16). Ka një *j* fundore pas zanoreve në: *kefaay*, *ndr8fcey*, *t88y* dhe në trajta të ndryshme foljore: *haay*, *mengoy*, *duoy*, *gindeey*, *mbeliçeey*, *kijy*, *pijy*. Ka një *j* midis bashkëtingëllores e zanores në fjalë si p.sh. *fyale*, *dyaall* (dhe *diaall*), *dyaççete*, *gindya*, *eyarm*. Më në fund, ka një *j* midis zanores e bashkëtingëllores në p.sh. *cuuynay*, *cungoy/c*, *leftoyme*, *levdoy/c*, *cuydef* (dhe *cuidef*), *fruyt* (*fruit*), *dereyte*, *biyte*, *diiytune*, *d88te*.

Trajtat e shquara të fjalëve si *grigj*, *ligj* janë shkruar *grigia*, *ligia*, që flet për një shqiptim *grigja*, *ligja* ku një *j* shkrihet në një *gj* paraardhëse. Emrat e shumtë më *-ij* (*-ii*) e kanë trajtën e shquar më *-ia*, rrjedhoren më *-ie(t)*. Mund të mendohet se shqiptimi i vërtetë këtu është *-ija*, *ije(t)*, por tingulli *j*, duket se do të ketë qenë mjaft i dobët falë një kalimi të butë nga *i*-ja paraardhëse, dhe nuk është shkruar asnjëherë. Natyrisht transkriptimi në këto raste do t'i mbahet grafisë së Budit, aq më tepër se i përgjigjet edhe praktikës së sotme. Fjalët e shumta më *-tione*, *-ntie* janë pas gjase shprehje diturore pak të njohura jashtë gjuhës librore, prandaj duhen dhënë si *-cione*, *-ncie* në pajtim me shqiptimin e italishtes (për tingullin *c*, khs. grafinë në *fentenzia* 386.11). Këtu po ashtu hamendësojmë një *j* të nyjetuar dobët si një *glide* midis *i* dhe zanores pasardhëse. Por Budi asnjëherë nuk e ka shkruar atë, as në rase emërore si *devotione*, *reuerentie* të dyja në 173.8), as në një trajtë si *negromantie/e* 31.21. Ka një grup zanor pa *j* në fjalën *hie* dhe derivatet e saj, p.sh. *paahie/cim*. Megjithatë, një *j* haset në *mie*, *miye* (*mijë*), e shkruar përjashtimisht si *mye* në 64.6; 150.18; khs. fjalën *ijë*, të cilën Budi e shkruan *iye* DC 184.12.

Etimologjia e përemrave *cilli* dhe e derivateve të tyre është e debatuar¹². Trajtat e eptuara duket të jenë ndërtuar mbi temat *cij-*, *tij-*, por Budi asnjëherë nuk shkruan *j* në forma si *ezia*, *zeziet*, *teziate*. Nëse supozojmë se një *j* shqiptohet vërtet në raste si këto, duhet të supozojmë edhe se kombinimi i shkronjave *ij* ka kuptimin *ij* në trajta si *tezijne*, *tezijte*; dhe kjo do të ishte në kundërshtim me konvencionet e zakonshme drejtshkrimore të SC. Në raste të veçanta hasim grafi si: *ubaa eatya giaame... faa* 389.19 (*u baa e atia gjaamë... saa*), *ptatyat caffce* 59.16 (*për t atiat kafshë*). Por leximi i kësaj mënyre shkrimi është po ashtu i pasigurt; ne jemi të prirur ta marrim *y*-në si një variant thjesht tipografik të *ij*-së.

Parimet e standardit të sotëm kërkojnë që të shkruhet *-ij* në trajtat e gjinore-dhanores të përemrave dëftorë, por trajtat e Budit *tij*, *atij*, *ketij* pa dyshim duhen barazuar me *ii*-në e zakonshme të gegërishtes. Ka gjithashtu një *-ii* në fjalë si *e mij*, *pmbij*, *trij*. Pranohet përgjithësisht se ka një bashkëtingëllore fundore në format e përemrave pronorë *tij*, *sij* “juaj”. Ka dhe një formë të eptuar *gniay* (*njaj*) që i përket *gnie* (*një*); ndoshta varianti *gnij* duhet lexuar *njij*.

Tingulli *n* palatal (*nj* në drejtshkrimin e sotëm) ka një gjegjës të saktë në italishte, ku shkruhet *gn*. Budi e ka përdorur rregullisht këtë model jovetëm përpara *i*: *gnifete* (*njifetë*), *degni* (*denji*), por edhe në fund të fjalës: *forzogn*, *mundegn*, *vign*, *upefçkepign* (*forconj*, *mundënj*, *vinj*, *upeshkëpinj*)) dhe para bashkëtingëlloreve: *luagnte* (*luanjtë*). Përpara zanoreve të tjera futet një tjetër *i* (madje edhe *y*) pas *gn*, megjithëse për sa i përket nyjëtimin është redondante: *gnioh*, *gnyofune* (*njoh*, *njofune*), *gnie*, *gnye*, *gnia* (*një*, *nja*), *degnie* (*denjë*), *Cufignie/cit* (*kufinjeshit*), *ëotgnie/ë* ose *ëotgnye/ë* (*zotnjësë*), *bagniene* ose *bagnylene* (*banjënë*) e të tjera si këto. Grafi si *gnoh*, *gne* janë relativisht të rralla.

Budi ka një *nj* në foljen *njimt*, *njimtoj* “gënjej” dhe derivatet e saj; por në 323.30 gjejmë *amofki/gnie nimptune entruõ* (*a mos kishnje nimptunë e ntruom*)*. Folja që i përgjigjet trajtës së sotme standarde *mallëngjej* në SC është përdorur me *nj*: *ete mallegn8emite* 117.16 (*e të mallënjyemitë*), *Mallegnimi* 4.27 (*mallënjimi*). Këto janë pikërisht format e dhëna për gegërishten e sotme: *mallnjehem*, *mallnjim* (Bashkimi, 250).

Identifikimi i *m*-së nuk shkakton probleme.

Grupi *mb* është ruajtur mirë në fjalë si *mb(ë)*, *mbi*, *mbas*, *mbastonj*, *mbulonj*, *mbyth*, *mbzii*, *përmbyth*, *shqimb* etj. Para një bashkëtingëllorese të shurdhët *mb* shpesh bëhet *mp*: *scitje mp/cchielm* 235.6 (*shtie mb shqelm*), – *mpctraee* 252.15-16 (*mp shtrazë*, gabim shtypi: ky emër zakonisht shkruhet

¹² Shpjegimi i dhënë nga Çabej përsëritet te Demiraj, 1973, 143 (shënimi).

* Folja *nimpt* në këtë shembull të Budit duket të jetë një me *namunë* (SC 75.19) me kuptimin “mallkoj” (shën. i përkth.).

fctræe), – *ndyrempta/cti* 366.25-26 (*ndjerë mp tashti*; gabim shtypi, khs. *ndyerempta/cti* 367.12, ku *t*-ja e parë është kthyer përmbys), – *chia /fctijm mphecura* 37.12 (*qi a shtiim mp hekura*). Fjalja *ete mp/ctetee/c... preinzi* 221.21-22 (*e t mpshteteesh.. prej nci*) që do të thotë diçka si “që duhet të rrish larg prej tij”^{**} po ashtu hyn këtu.

Budi ka përdorur *mp* në *mpsheh*: *emp/cehune* 4.15, *mp/cehune* 188.11, – *mpshinj*: *mp/ci/ctepijne* 47.20, *eemp/cijne* 255.16, – *mp/cicaæete* 92.3 (*mpshikazëtë* “fshikëzat e mëndafshit”). Këto fjalë tani shqiptohen *fsheh*, *fshij*, *fshikë*. Nga ana tjetër gjejmë *effcianetine* [5.2-3] (*e fshanëtinë*)¹³. Grupi *mp* shfaqet p.sh. në *temptuom* 244.24, por në 232.19 kemi *tentuom*. Të dyja grafitë mund të jenë të drejta: *temptuom* mund të jetë latinizëm (*temptare*), kurse *tentuom* (sot: *tentoj*) është një italianizëm (*tentare*).

Fjala për “pagëzim” shkruhet *Bakmine* 338.22.

Është karakteristike e gjuhës së SC që grupi *mt* të zhvillohet në *mpt*. Kjo ndodh shpesh në kufi të fjalëve. Khs. *pndoognie dampte /cpijrtit* 243.10-11 (për *ndoonjë damp të shpiirtit*), *endeme damptegiaa/fe ete ndeer/fevet* 340.24 (*ende me damp të gjaasë e të ndeersë vet*), *tue cuytuom damptee /scinte/efee* 333.27 (*tue kujtuom damphtë e shintesë fee*) – të gjitha këto i përkasin fjalës *dam* (edhe mashkullor edhe asnjans në gjuhën e Budit). Më tej: *ende eyarmpte Ame/ciuom* 197.5 (pas gjase një lokativ, *e ndë zjarmp-të amëshuom*; e njëjta shprehje është përdorur në 386.1) i përkasin fjalës *zjarm*. Grupi sekondar *mpt* gjithashtu mund të dalë në trup të fjalës: *gjymtyrë* nganjëherë bëhet *g8mpt8re* 287.7 (*gjymtyrë*), *eg8mpt8reetuu* 194.3. Fjala *e premtë* shkruhet *tepremtë* 37.24. Folja *shëmtoj* (sipas etimologjisë së Çabejt në origjinë *shentonj*) zakonisht jepet si *shemtonj* në SC, por në 201.31-202.1 gjejmë */cemptuome*; gegërishtja e sotme i ka të dyja, *shëmtoj* dhe *shëmptoj* (Bashkimi, 417).

Në [5.10-12] është pasazhi: *nda/cte keyo vepere, pndoognye ndime oo fruytemire te/cpijrtit, tempte etatij Populli*; pas gjase kjo do të thotë diçka si: “në qoftë se kjo vepër është për ndonjë ndihmë a fryt të shpirtit (dmth.: është i dobishëm për shpirtin), *tempte* dhe të atij populli. Shuteriqi e ka transkriptuar këtë pasazh: *nd’ashtë këjo vepërë për ndoonjë ndimë oo frujtë mirë të shpijrtit tem e t’atij populli*¹⁴. Leximi i tij ndryshon nga yni në njady pika më pak domethënëse, por kryesorja është se ai e ka kuptuar enigmatiken *tempte* si një lloj gabim shtypi. Duke hequr *-pte*-në ai lehtëson leximin dhe arrin në një ndërtim që jep kuptim të drejtë: “... të shpirtit tim dhe të atij të popullit”.

^{**} Kuptimi në fakt është “të mbështetesh tek ai”, ku *prej* = “drejt, në drejtim të, tek” (shën. i përkth.).

¹³ Për alternimin e nistoreve *sh ~ fsh ~ mpsh* khs. Çabej, 1973², f. 204.6. Kristoforidhi jep *pshekëzë* (*mpshikëzë*, *fshikëzë*) “βομβάκιον, κουκούλιον μεταξοώληξ”).

¹⁴ Shuteriqi, 1955, f. 25.

Megjithatë, kjo zgjidhje duket mjaft drastike. Mund të jetë e pranueshme ta konsiderojmë *te*-në të tepërt nga ana tipografike – ky element është kaq i shpeshtë saqë me sa duket e ngatërrojnë një tipograf që nuk e njihë gjuhën në të cilën po radhiste. Por nuk mund t'i shmangemi faktit se *te*-ja është e nevojshme në këtë vend, sepse është e vetmja mënyrë me të cilën mund të shpjegojmë *p*-në, e cila duhet të jetë zhvilluar midis *m* dhe *t*. Kështu, *tempte* e Budit është në fund të fundit e përligjur ashtu siç është aty. Ne e marrim si të jetë përemri pronor i shquar në kallëzore njëjës (trajta e mashkullores); formalisht ai i referohet *frujt*-it. Megjithatë, në pajtim me kuptimin e këtij pasazhi i marrë si i tërë, përemri i përket *shpiirtit* si një ndajshim; që këtej ne do të kishim pritur trajtën e gjinorese së shquar *timit*. Ne e lexojmë këtë pasazh: *nd ashtë këjo vepërë për ndoonjë ndimë oo fruj-të mirë të shpiirtit, temptë e t atii populli*.

Fjala *mcat* (*mkat*) shpesh shkruhet *mpcat*: *cmpcatete* 179.20 (gabim shtypi: *e mpkatetë*), *mpcatet* 190.22, *mpcatnec* 326.15 (gabim shtypi: *mpkatnë e*), *mpcatevet* etj. Kur e krahasojmë me *mkat*, (*për*)*mkatënuom* e të tjera si këto, që gjithashtu përdoren, *p*-ja duket se është një epentezë. Mirëpo kjo nuk duket të jetë ky rast. Te *mpkat*, *m*-ja mund të jetë një protezë: fjala është përshtatur nga latinishtja *peccat(um)*.

Një *m*-protetike para *p* është përdorur në *ndermpfalmitet* 26.5 (*ndër mpsalmi-të vet*), *nder mpfalmit* 309.6 (*ndër mpsalmit*). Në mënyrë të ngjashme gjejmë *impokritetee* 205.22 (*impokritetë e*), *Impochrefia* 299.30 (*impokresia*), – por *Ipokrit* 116.1. Në fjalën *impedit* 396.17, *m*-ja pa dyshim është e përligjur (italisht *impedito*); por në *improibit* 31.28, e cila duket qartë se është një refleks i italishtes *proibito*, ajo është sekondare. Nistorja *i*- është e paqartë, ndoshta *im*-si e tërë ka hyrë nga fjalët e shumta italiane që kanë kuptime negative ose privative.

Një *m* sekondare del nga *n* përpara një bashkëtingëlloreje buzore me asimilim. Për shembull parafjala *n* (me kallëzore ose rrjedhore) ka pësuar ndryshim në *mbefë* 92.7 (*m besë*), *mpach* 62.24 *m paq*), *mbruofcit* 108.6 (*m bruoshit*), *mpafcke/cize* 393.23 (*m pashkëshit së*). Fjala *fçen*: *fçem Pietre* 42.26; 399.14, *khs*. 155.27 – por jo rregullisht: *ifçen Bernardij* 281.6. Titulli klerikal *Don* shqiptohet: *Dom Pietre* (titulli, 8), *Dom Pyetre* 401.21-22 – por edhe *Dom Simone* 6.11.

Është e lehtë të identifikohet *n*-ja në çdo lloj konteksti.

Grupi *nd* ruhet mirë në të gjitha pozicionet: *ndeer*, *ndë*, *nder*, *ndënë*, *ndonjë*, *këndellem*, *gazimend* etj. Ne e lexojmë si përjashtim *peredon* 48.26, pas gjase një gabim shtypi i *perëndon*.

Grupet *nk*, *nt* janë ruajtur në disa leksema. Ne gjejmë p.sh. *kankë* “këngë”; *ecanketee engijvet* 210.5, *cankene* 388.24; – *afya caanta* 36.21, *eycaanta* 392.3; – *oocundra aantefe t8ne* 241.27-28; *i lintë* “prej liri”; *petek telinte* 292.27, *mbafite ndorrognetelintate* 132.1 (*mbasi të ndërronjë të lintatë*). Ka

grafi alternative si *cuvend* dhe *cuvent*, *ment* dhe *mend* (*mendne* 179.22). it. *contento* është përshtatur si *content* – por shkruhet edhe *contend* 59.1; 322.9 (në gegërishten e sotme: *kondend*). Krahas *concupine* 70.28 Budi shkruan edhe *congubine* 21.12.

Grupi *tn* përgjithësisht ruhet në kallëzore si *motne* 24.18; 403.25 (khs. të sotmen *gjithmonë* < *gjithë motnë*), *mpcatnec* 326.15 (gabim shtypi: *mpkatnë e*), *tevetne* 292.3 (*të vetnë*; por: *evdierre mente vene* 111.17 e *vdjerrë men-të venë*).

Për asimilimin e grupit *rn* > *rr*, *lln* > *ll* khs. f. 9-11.

Nëse rrjedhorja e nyjës konektive *së* nuk vjen menjëherë pas një forme rasore, ajo kombinohet me një *n*- (në origjinë parafjalë) në grupin *ncë* (shkruar *nze*). Kjo *n* sekondare futet gjithashtu në përemrat dëftorë: (*kë-/a-nci(sh)*, *kë-/a-nco(je, -sh)*).

Për sa i përket përndarjes së shkronjave *u* dhe *v* në drejtshkrimin e Budit dhe identifikimit të bashkëtingëllores *v*, khs. f. 21.

Bashkëtingëllorja *f* shkruhet gjithmonë kështu dhe prandaj është e lehtë për t'u identifikuar. Për ndërndërrimin *f* ~ *h*, shih më lart, f. 13. Ne nuk kemi gjetur dëshmi të ndërndërrimit *f* ~ *th*, i cili është mjaft i përhapur në të folmet e sotme¹⁵.

VIII.

Gjatë leximit dhe transkriptimit të SC është e vështirë të ndiqet drejtshkrimi në një tjetër pikë thelbësore: sonantet.

Nga gjuha e folur e sotme është e ditur se zanoret *i* dhe *u* shpesh sillen si gjysmëzanore (ose, po të doni, “gjysmëbashkëtingëllore”), domethënë: *ĩ* dhe *ũ* që formojnë diftongje me zanoret paraprijëse ose ndjekëse. Trajtat e aoristit që në drejtshkrimin standard jepen si *kërkoĩ*, *lau* përgjithësisht shqiptohen *kërkoĩ*, *lau* dhe trajtat e shkurtra përemërore si *iu*, *ua* zakonisht bëhen *ĩu*, *ũa* në të folurit e rrjedhshëm. Të tilla raste e të tjera si këto paraqesin problem edhe në tekstet e vjetra shqipe që njohim. Analiza e alfabetit dhe drejtshkrimit të *Mesharit* të Buzukut ka treguar se përveç *v* dhe *u* ky tekst dallon edhe një *ũ*, të cilin autori madje e shënoi me një shkronjë të posaçme (i ashtuquajtur *uk* i shkrimit cirilik). Ai përdorej kryesisht në pozicione nistore e fundore, dmth. në pozicione ku kryhej diftongimi¹⁶. Një dukuri e ngjashme duhet të supozohet në të njëjtat kushte për *ĩ* si dhe për *i* dhe bashkëtingëlloren e plotë *j*, megjithëse nuk është shprehur në grafinë e Buzukut¹⁷. Ndërsa tingujt *m*, *n*, *r*, *l* para bashkëtingëlloreve, në *Mesharin* e 1555-s mendohet se kanë pasur një të ashtuquajtur shqiptim gjysmëzanor apo sonantik, i cili shprehej me grafitë *en*,

¹⁵ Për këtë lloj shndërrimi, khs. Çabej, 1973², f. 200-4.

¹⁶ Çabej, 1968, f. 50-53; 74.

¹⁷ Çabej, 1968, f. 73.

er etj., dhe të cilat botuesi modern vendosi t’i japë *m*, *n* etj. në transkriptimin e tij¹⁸.

Ne nuk do të përsërisim argumentet e dhëna tashmë në lidhje me këto probleme. Por duam të theksojmë çështjen e rëndësishme të gjysmëzanoreve meqë kjo lidhet edhe me tekstin e Budit.

Do të sjellim ndër mend që grafitë e Buzukut *enprehune*, *enbare*, *endeer*, *engignune* shpesh janë kuptuar si *ëmprehunë*, *ëmbarrë*, *ënder*, *ënginjunë*. Në kundërshtim me këtë pikëpamje Çabej ka pohuar se *e*-ja ortografike nuk mund t’i përgjigjet ndonjë zanoreje sepse *a* para *ë* nuk elidohet asnjëherë. Krejt në përputhje me këtë parim, ne nuk gjejmë elizion as në SC: *moshine ndemenijte* 221.9-10 (*mos hinë ndë mëni të*), *imarrene mbe vetehe* 68.19 (*i marrënë mbë vetëhe*), *afcte giççehere mcat murtaar* 48.13 (*ashtë gjithëherë mkat murtaar*) e kështu me radhë¹⁹. Që para bashkëtingëlloreve *n*, *m* te Budi në këto raste e të tjera si këto nuk ka pasur zanore, del qartë nga vargjet e tij, ku ato asnjëherë nuk llogariten si një këmbë metrike:

Onchiel/cit ndimayone (403.1)

O, n qiellshit ndima jonë

1 23 4 4 5 6 7

Nkççeu mbenevoye tone (403.3)

nkthe u mbë nevojë tonë

1 2 3 4 5 6 7 8

Nkifcet /cinte tue vote (404.2)

n kishët shinte tue votë

1 2 3 4 5 6 7 8

Ne nuk e dimë me siguri se si realizoheshin fonetikisht *n*, *m* në këto raste. Por, meqë ato nuk ishin zanore, dhe meqë Budi nuk i shkruante si *en-*, *em-* (në dallim me Buzukun), mund të supozojmë se ai vetë i kuptonte ato si bashkëtingëllore të zakonshme më shumë sesa gjysmëbashkëtingëllore apo sonante *n* *m*; për këtë arsye parapëlqejmë të ruajmë grafinë e autorit në transkriptim.

Sigurisht, në disa raste gjejmë grafinë *en* etj. edhe në SC. Por, në radhë të parë këto raste nuk janë të shumta; dhe, së dyti, ato duket se përqendrohen rreth disa fjalëve të veçanta. Parafjala *n* + *gjithë* normalisht shkruhet *ngiççe*, por nganjëherë gjejmë edhe p.sh. *engiççauzifc* 227.24 (*n gjith ancish*; gabim shtypi për” -ncifc), *en giççe pallavijfcize mcatevet*) *engiççe nzos* 24.20 (*n gjithë*

¹⁸ Çabej, 1968, f. 54-55; 75.

¹⁹ Kriteri i elizionit të *ë*-së para zanoreve nuk mund të zbatohet plotësisht në SC. Një *ë* zakonisht elidohet, por jo rregullisht. Ndoshta kjo ka të bëjë me përndarjen e pauzave dhe një lloj ndarjeje të ligjërimit në masa të të folurit.

ncosh), *engiççe anziç* 57.21, *evaayenzifc* 57.29 (*e vaaj ncish*). Me raste lexojmë edhe: *emeu fciyuom onderto* 82.17 (*e me u shijuom ndër to*; gabim shtyp: *onderto* në vend të *enderto*), *mbacenzoye* 316.23 (*mbas ncoje*; gabim shtypi), *largencefc* 325.20-21 (*larg ncish*; gabim shtypi). Ndoshta është simptomatike që shembuj të tillë hasen në kontekste ku gjenden edhe parregullsi të tjera. Në faqen 47.30 gjejmë: *ooafctu afere chi emberrini nde Cohote Meçese*. Këtu leximi nuk është krejt i qartë. Në qoftë se ndjekim ndarjen e fjalëve të dhënë nga teksti i shtypur, kemi: *oo ashtu afërë, qi mbërrini ndë koho-të meshësë*; por ndoshta leximi që *mbërrini* është i mundshëm (megjithëse pak i gjasshëm, meqenëse forma e zakonshme e lidhëzës në SC është *qi*). Sido që të jetë, të gjitha këto raste me *en-* s'janë veçse relike të konvencioneve drejtshkrimore më të hershme; ato nuk vërtetojnë as praninë e një zanoreje dhe as shqiptimin zanor ose gjysmëzanor të hundores.

Ndërsa lidhur me një shqiptim të mundshëm të një *r*-je para një bashkëtingëlloreje si një *r* gjysmëzanore (khs. transkriptimin *rdhī* të Çabejt për *erçii* të Buzukut), teksti i Budit nuk ofron material mbështetës për ta argumentuar. Fjala e cituar nga Buzuku nuk gjendet në SC; dhe në fjalën *rgjand*, që del disa herë, nuk gjejmë asgjë që të flasë për tjetër gjë veç një bashkëtingëlloreje të zakonshme *r* (khs. më lart, f. 8-9).

Gjithsesi, fjala për “altar” sugjeron se të paktën kjo fjalë që përmban një *l* para një bashkëtingëlloreje mund të ketë pasur një shqiptim me një karakter të vetin. Krejt natyrshëm, fjala është mjaft e shpeshtë në një tekst fetar si SC, dhe prandaj ne kemi një rast shumë të mirë për ta vërejtur atë në nuancat e saj të ndryshme. Në faqen 133.8 Budi përdor një shprehje greqisht *Alterion tebeecuom*, por përveç kësaj, forma e zakonshme e fjalës është *lteer* (nga lat. *altare*) – dhe kjo i përgjigjet saktësisht asaj që jepet për gegërishten (Bashkimi, 238). Kjo duhet përfillur si trajta bazë e fjalës, e cila përdoret p.sh. në *mbelteer* [13.15]; 327.11; 391.9, *mbelteerte* 128.29; 396.7, dhe kështu lexojmë: *mbë lteer* (-të). Krahës kësaj, ekziston një variant i përdorur shpesh *ilteer* me një *i*-nistore që kishte si funksion pa dyshim lehtësimin e shqiptimit të grupit bashkëtingëllor të pazakonshëm *lt-*: *ppara fçintit Sachrament eliterit* [5.1] (*përpara shintit sakrament-të ilterit*), *oopkete ilteer* 40.26 (*oo për këtë ilteer*), *oopmbij napete ilterit* 136.21 (*oo përmbii napë-të ilterit*), *nkççegniene fçpinene ilterit* 181.9 (*nkthenjënë shpinënë ilterit*), *ppara ilterit* 252.31 (*përpara ilterit*), *ndefçintit Sachramente Ilterit* 301.27 (*ndë shintit sakramen-të ilterit*), *ppara gnay ilteri* 315.11 (*përpara njaj ilteri*), *corporayte enapetee ilterevet* 395.26 (*korporajtë e napëtë e ilterëvet*), *mbe fçintit ilteertetij* 399. 4 (*mbë shintit ilteer të tij*). Në këtë kontekst, është interesante të gjejmë p.sh. *mbilteerte tineçot* 282.21 (*mb ilteer-të Tinëzot*), që duhet krahasuar me *mbelteer* të përmendur më lart: natyrisht *lteer* dhe *ilteer* janë vetëm variante. Që *i*-ja gjithsesi nuk ishte thjesht një trill drejtshkrimor, mund të pohohet nga raste ku ajo shqiptohej *i* dhe shkruhej *j* (te Budi: *y*) pas një zanoreje: *ppara fçintit Sachrament*, *ooylterit*

303.3 (*përpara shintit sakrament oo jlterit*), *eme viſituom kiſcete ſcinte, eylderette* 307.28 (*e me vizituom kishëtë shinte e jlterëtë*), *kiſcete eyldereteet8ne* 342.31 (*kishëtë e jlterë-të e tyne*). Buzuku këtë fjalë e shkruante: *elteer*²⁰.

Siç është thënë më lart, grafia e Budit mbart gjurmë të rregullit thjesht tipografik që v duhet përdorur në fillim të fjalës, ndërsa shkronja *u* përdoret në trup të fjalës – ku të dyja shkronjat shprehin si [u] ashtu edhe [v]. Në të njëjtën kohë ne kemi vërtetuar se, gjithsesi, parimi kryesor drejtshkrimor në SC është që zanorja *u* shkruhet me shkronjën *u* (edhe në fillim të fjalës) dhe se bashkëtingëllorja *v* normalisht jepet si *v* (edhe brenda fjalës). Këto parime që kundërshtojnë njëri-tjetrin janë arsyeja përse është e vështirë të vendosim, me njëfarë shkalle sigurie, nëse teksti përmban dëshmi të një shqiptimi *u* aq të qartë sa të ketë pasoja për një transkriptim. Budi nuk e përdor shkronjën e posaçme të Buzukut për gjysmëzanoren dybuzore [w], dhe kjo rrethanë mjafton për të kuptuar se një transkriptim me *u* do të ishte një hiperinterpretim i tekstit; ne nuk mund të jemi krejtësisht të sigurt për realizimin fonetik të këtij tingulli. Shembuj si *tetape vrte* 179.7 (*të t apë urtë*), *chiſc vbaa vbaa* 349.6 (*qish u baa, u baa*), *vlus* 400.5 (*u lus*) pak gjë na thonë – ato janë më shumë ilustrime për prirjen tipografike të sapopërmendur për të përdorur shkronjën *v* në fillim të fjalës pavarësisht nga vlera e saj fonetike. Po ashtu lidhja *u + e* jepet në formën e kombinimit *ua* pa një dëshmi të qartë të cilësisë fonetike të kësaj grafie, p.sh. *pratauaça* 382.21 *pr ata u a dha*). Në këtë pikë të veçantë metrika e Budit nuk është vendimtare. Në vargje si:

Nzeriu ende plechienij (406.19)

n cë riu e ndë pleqëni

1 2 3 4 5 6 7 8

Ndarbene mea derguom (408.1)

nd Arbënë me u a dërguom

1 2 3 4 5 6 7 8

duket e nevojshme të paravendojmë një shqiptim *riu*, *ua* në mënyrë që të ruajmë një metër tetërrokësh. Nga ana tjetër ka një shqiptim me zanore të plotë në raste si:

Nkççeu mbenevoye tone (403.4)

nkthe u mbë nevojë-tonë

1 2 3 4 5 6 7 8

Pofi ucu iterbuom (405.29)

posi uku i tërbuom

²⁰ Çabej, 1968, f. 54. (Fusnota mungon në origjinal. Në f. 54 të Çabejt jepet vetëm shembulli i transkriptuar: *të lterit*).

1 2 3 4 5 6 78
Mcatit tue u larguom (408.9)
 mkatit tue u larguom
 1 2 34 5 6 78
pyetet meugeuom (408.19)
 për jetët me u gëzuom
 1 2 3 4 5 6 78

Khs. edhe rreshtat 406.29; 408.3; 408.13. Duket se kërkesat e metrit i kanë lejuar ose imponuar Budit njëfarë lirie; prandaj dëshmitë si këto nuk janë vendimtare për të nxjerrë përfundime. Në rrethana të tilla ne ndiejmë se do të ishte më me vend t'i shmangeshim përdorimit të *u*-së dhe ta shpërndajmë *u*-në dhe *v*-në në pajtim me standardet e sotme, duke e lënë çështjen e shqiptimit të saktë të pavendosur.

Siç është thënë më lart, në drejtshkrimin e Buzukut del se është e pamundur të gjurmosh një gjysmëzanore të hamendësuar *i* që i përgjigjet një *i*-je vokalike dhe një *j*-je konsonantike; prandaj botimi kritik i këtij teksti përdor vetëm shkronjat *i* dhe *j*.

Me Budin çështja qëndron ndryshe.

Siç e dimë, Budi si rregull e tregon zanoren *i* me shkronjën *i*, kurse shkronjën *y* zakonisht e përdor për të shënuar bashkëtingëlloren *j*. Tani, kudo ku mund ta ndjekim drejtshkrimin e tij me siguri, duket se gjysmëzanorja *i* që del nga diftongimi shkruhet rregullisht *y* në SC: *le/cioy* 348.15, *pefoy* 348.17 (aoriste, veta 3 nj., që u përgjigjen *lëshoi*, *pësoi* në standardin e sotëm). Me fjalë të tjera, Budi duhet ta ketë konceptuar këtë tingull si një lloj bashkëtingëlloreje, dhe kjo është arsyeja pse ne parapëlqejmë ta shkruajmë *j*: *lëshoj*, *pësoj*, edhe pse kjo mënyrë shkrimi nuk pajtohet me normat e tanishme në fuqi. Shembujt e kësaj *j*-je të veçantë (*j*) janë tejet të shumtë gjatë gjithë SC dhe ne këtu do të kufizohemi të japim disa mostra të përzgjedhura: *kecuoytoy e/cperey* 244.7 (*ke kujtoj e shpërej*), *giççimire eyfe/cim* 172.1-2 (*gjith i mirë e j feeshim*), *ifratenet, ey atet /cintene* 291.19 (*i fratënet e j atet shintëne*), *mey gniofune* 160.22 (*me j njofunë*), *yambrini* 383.22-23 (*j a mbërrini*), *meyu rref8em* 119.28 (*me j u rrëfyem*). Në të njëjtën kohë duhet mbajtur në mend se grafitë me *i* janë po ashtu të mundshme: *iu*, *ia* – ose p.sh. *tueiççane/e* 66.11 (*tue i* (pas gjase e shqiptuar *j*) *thanë, se*), *traditoy* 383.3 (me gjasë e shqiptuar *traditoy*). Në sekuencën fonetike *ii* (*ij*) shqiptimi gjysmëzanor nuk mund të gjurmohet në shkrim në raste si: *atij /cpijrtit* 28.22, *ibirij tine8ot* 210.22, *Chri/ctij me/cerier/cim* 245.21, sepse kombinimi i shkronjave *ij* është mënyra e zakonshme e Budit për të treguar një *i* të gjatë. Prandaj ne parapëlqejmë t'i transkriptojmë kështu: *ati i shpiirtit*, *i biri i Tinëzot*, *Krishti i mëshëriershim*; por në të njëjtën kohë ne nuk e përjashtojmë mundësinë që shqiptimi të ketë

qenë: *ati j shpiirtit* etj. Në mënyrë të ngjashme, raste si *chijcaabaam* 272.6 (*qi i kaa baam*) mundet që kanë qenë shqiptuar *qi j kaa baam*).

Nëse analizojmë metrikën e Budit, gjejmë se ai e trajtonte lirisht ndërndërrimin $i \sim j$ (j). Në vargjet:

Chinee nangu/celloy (404.6)

qi nee na ngushëlloi

1 23 4 5 6 78

Vrçenoye efctampoy (404.8)

urdhënoj e e shtampoi

1 2 3 4 5 6 78

dy aoristet që rimojnë duhen lexuar me zanore të plotë, me gjithë -y-në drejtshkrimore. Nga ana tjetër, aoristi i parë në rreshtin e fundit duhet lexuar me -j (-i). Një gjysmëzanore del në

Chi eot88ne teyape (404.9)

qi Zotynë të japë

1 2 34 5 6 7 8

por jo p.sh. në

Oymaçi Eot fatmiri (405.3)

O, i madhi Zot fatmiri

1 2 3 4 5 6 7 8

Megjithatë, këtu autori shkruan y. Një varg si

Pofi ucu iterbuom (4-5.3)

posi uku i tërbuom

1 2 3 4 5 6 78

Duhet lexuar me zanore të plota – dhe jo *uku i*.

Kombinimi *Zoti im* del në vargje si

eotijm muo forzome (405.10)

Zoti im, muo forcomë

1 2 3 45 6 7 8

eotijm t88 fey8em (4-5.20)

Zoti im, ty fëjyem

1 2 3 45 6 78

dhe drejtshkrimi *ij* këtu llogaritet si dy rrokje. Në anën tjetër, duket se ka një shkurtim të *ii* në:

Oeotijm ingufcelluom (407.3)

O, Zoti im i ngushëlluom

1 2 3 4 5 6 7 8

IX.

Në gjuhën e sotme labiodentalet *f* e *v* përfaqësojnë qartësisht një çift bashkëtingëlloresh e shurdhët : e zëshme. Nëse ky ishte rasti edhe në kohën e Budit, duhet të jetë një çështje e hapur. Dikur bashkëtingëllorja *v* me shumë gjasë mund të ketë qenë dybuzore, por ne nuk e dimë nëse një shqiptim i tillë ruhej ende në fillim të shekullit XVII. Drejtshkrimi i SC nuk na jep një tregues lidhur me këtë çështje.

Për gjithë bashkëtingëlloret e tjera që nuk u përmendën më lart, mund të jemi të sigurt se ato përbëjnë çifte të shurdhëta: të zëshme, dhe në vijim ne do t'i trajtojmë edhe ato si çifte. Por më parë duam të pohojmë në mënyrë kategorike se SC nuk jep asnjë dëshmi për shndërrimin automatik bashkëtingëllore e zëshme > e shurdhët në fund të fjalës. Ky shndërrim, më karakteristik për toskërishten, ka ndodhur edhe në disa zona të gegërishtes, ndër të tjera në krahinën e Matit nga vinte Budi²¹.

Nuk ka problem për identifikimin e çifteve *p:b*, *t:d* të cilat janë shkruar në mënyrën normale.

Çifti *k:g* gjithashtu dallohet lehtë. Tingulli *k* shkruhet kryesisht *c* sipas drejtshkrimit italian. Por, meqenëse *ci*, *ce* e italishtes shqiptohet si afrikate: [tʃ], Budi nuk mund të përdorte *c* para zanoreve të përparme dhe i shtoi *k* alfabetit të tij. Për këtë arsye rregulli kryesor drejtshkrimor për SC është: *c* përdoret para zanoreve të prapme (*ca*, *co*, *cu* = *ka*, *ko*, *ku*), *k* përdoret me zanoret e përparme (*ke*, *ki*, *k8* = *ke/kë*, *ki*, *ky*); përjashtime nga ky rregull i përgjithshëm hasen, por ato janë të pakta dhe të parëndësishme për një lexim të tekstit. Në pozicione të tjera *k* zakonisht shkruhet *c*, por mund të shfaqet edhe *k*; përndarja nuk ndjek kriteret e rrepta (*crahanuor/krahanuor*, *craut8re/kraut8re*), por në pozicion fundor duket se parapëlqehet *-k* (*giak*, *pak* e të tjera si këto, por: *oo/implic* 18.28). Ka shembuj të ndryshëm të *k* të shkruar *ch*: *krahas* emrit të përveçëm *Chri/cti* ndër të tjera *Chatolike* 117.24 (por: *Catholize* 119.6), *Charitat* 165.19, *Chraut8ret* 214.5, *Chredine* 270.13 (por: *Kredine* 254.24), *chuur* 229.15, *Echlefiasticut* 55.12, *Ezechielt* 68.5, *Patriarche* 124,25, dhe mbi të gjitha fjala e shpeshtë *fachrament* (por p.sh. *facramente* 128.15).

Budi zgjodhi ta injorojë shqiptimin italian të *ge*, *gi* me afrikatë [dʒ] dhe e shkroi bashkëtingëlloren *g* me shkronjën *g* në të gjitha pozicionet – pra në raste

²¹ Khs. Beci, f. 259.

si *gevoyene* (gëvojënë), *tregetij* (tregëtii), *lengimevet* (lëngimevet), *ngign* (nginj) e të tjera.

Ka shembuj të një shndërrimi $p > b$ në: *burgatuor* “purgator”, *depërtonj*²²: *edebertuom* 225.13; 256.8, *debertogniene* 266.18. Një shndërrim gjegjës $k > g$ dëshmohet nga *gardinal* “kardinal”: *Gardinayet* [2.22], *oogardinayte* 35.14. Për shndërrimin $nk > ng$, shih më lart, f. 17-18.

Italishtja nuk njeh spirante ndërdhëmbore që t’u përgjigjen [p] : [ð] të shqipes – të shkruara si *th* : *dh* në drejtshkrimin e sotëm. Në vitin 1555 Buzuku shtiu në përdorim shkronjën cirilike *ksi* për të shënuar të dyja ndërdhëmboret e shqipes. Duket se Budi ishte i pari shkrimtar që pati mundësinë të kishte një shkronjë shtypi të sofistikuar dhe ai u përpoq të dallonte *xi*-në e shurdhët [p] nga e zëshmjja *xi* [ð]. Natyrisht këtu shkronjat dyfishe nuk kanë të bëjnë aspak me *geminacionin*.

Kjo mënyrë e veçantë shënimi e bën bashkëtingëlloren në fjalë të lehtë për t’u identifikuar. Por shkronja e huaj duhet të ketë qenë e vështirë për tipografët, dhe rezultati ishte shumë pak gabime shtypi. Shumica e tyre janë të parëndësishme, megjithëse fjala tejet e shpeshtë *giççe* (*gjithë*) është shtypur *pgiççe* 171.29, *gizççe* 72.14, *figiççe* 92.13, *eçmbijgiççe* 362.22. Shembulli në 171.29 ka si shkronjë të katërt figurën e numrit tre (dmth. shkronja e zakonshme e Budit 3 (= z) e përmbysur. Shembulli në 72.14 ilustron ngatërrimin e *xi* me *z* që dëshmohet disa herë në SC (khs. *etaçvrafene* 38.9 në vend të *etazvrasene*, ndoshta *e t a xhvasënë*). Në shprehjen *megi çeletaniit* (*me gjithë lëtaniit*) 9.15, mungon një *xi* në hapësirën bosh. Në tërësi, gabimet tipografike në SC janë që një *xi* e vetme shtypet në vend të *xi*, asnjëherë e kundërta. Këtu kemi disa shembuj tipikë: *çdegniene* 68.23 (*thyenjëne*), *Driçete* 92.14 (*drithëtë*), *çoy* 327.21 (gabim shtypi: *thuo*), *tapuç* 387.22 (*t a puth*; por në rreshtin tjetër: *etuepuççune* (*e tue e puthunë*)). Ka një *-th* fundore në fjalë si *daleç* 29.1, *caadalç* 147.29 (gabim shtypi për *-leç*(*xi*)), *pocaadaleç* 150.10. Fjala *rreth* shumë shpesh është shkruar me *xi*: *rreç* 250.11, *rreçne* 222.29; 385.29, *rreçneefceculit* 189.30, *rreçte* 217.6; 285.19.

Sa i përket drejtshkrimit *th*, të krahasohet f. 32.

Nuk kemi vënë re ndonjë shembull ndërndërrimi $th \sim f$, $dh \sim ll$ të njohur për të folmet e sotme.

Tetë fishkëllyeset e shqipes përbëjnë një sistem që mbahet nga kundërvënia e shurdhët : e zëshme dhe joafrikative : afrikative:

<i>s</i> : <i>z</i>	<i>s</i> : <i>c</i>
<i>sh</i> : <i>zh</i>	<i>sh</i> : <i>ç</i>
<i>c</i> : <i>x</i>	<i>z</i> : <i>x</i>
<i>ç</i> : <i>xh</i>	<i>zh</i> : <i>xh</i>

²² Formuar nga *ndë(r)për*. Buzuku ka *derpërtonj*, Bardhi *depërtonj*, *derpëtonj*.

Me përjashtim të *zh-së* të gjithë këta tinguj gjenden edhe në italisht, ku secili nga çiftet *s : z* dhe *c : x* shkruhen me të njëjtat shkronja: përkatësisht *s* (*cosa : rosa*) dhe *z* (*zoppo : zona*). Për bashkëtingëlloren *sh* nuk ka një shkronjë të posaçme në italishte, e cila përdor *sc* para zanoreve të përparme (*scendere, scivoloso*) por *sci* para zanoreve të prapme (*scialto, sciolto, sciupare*). Në mënyrë të ngjashme italishtja nuk ka shkronja të posaçme për *ç* e *xh* por përdor *c* dhe *g* përkatësisht para zanoreve të përparme (*cento, cinque, – gente, giro*) dhe *ci* para zanoreve të prapme (*ciarlare, ciò, ciurlare – giallo, giorno, giunto*).

Nga paraardhësi i tij (Buzuku) Budi mori shenjën *ε* me kuptimin *z*, por përndryshe ai e mbështeti drejtshkrimin e tij në konvencionet italiane si zakonisht. Ky parim çoi pashmangshëm në zgjidhje të vagullta në disa pika – pjesërisht sepse çiftet e fishkëllueseve janë të ndryshme në shqipe e në italishte, dhe pjesërisht sepse disa fishkëlluese që i kanë të dyja gjuhët kanë një përndarje specifike në secilën prej tyre.

Në SC dallimi midis *s* e *z* është i qartë. Ato dallohen rregullisht mes tyre, meqë *s*-ja shkruhet */*, *s* (për përndarjen e këtyre shkronjave shih më lart), kurse *z*-ja është shtypur me shkronjën e posaçme shqipe *ε*. Kështu, identifikimi në shumë raste nuk përbën problem. Megjithatë, meqë të dyja bashkëtingëlloret shkruhen në të njëjtën mënyrë në italishte, duhet të jemi të kujdesshëm në leximin e SC pasi tingulli *z* në disa raste mund të shkruhet si */* ose *s* – si në modelin drejtshkrimor (asnjëherë anasjelltas).

Lat. *causa* është marrë drejtpërdrejt dhe përdoret shpesh gjatë gjithë SC. Si rregull shkruhet *caufa*, *caufet* e kështu me radhë, por *cauea* 95.31-96.1 zbulon shqiptimin e saj të vërtetë. E njëjta gjë vlen edhe për *fantasij* që përmban një fishkëlluese të zëshme, khs. *fantæijfcit* 224.21. Normalisht Budi shkruan *geonem* e të ngjashme me të, por ne gjejmë edhe *gefonete* 370.6. Shembuj të *s* në vend të *ε* (*z*) përfshijnë ndër të tjera edhe: *Sadrimefe* (faqja e ballinës, 9; khs. [6.12]; 401.24) (*Zadrimës*) – *psaconimoti* 339.14 (*për zakoni moti*) – *pome mbsij* 369.14 (*po mbzii*) – *emeumerfitune* 400.4 (*e me u mërzitunë*) – *vifituom* 124.18-19. Pas gjase ka një *s* reale në fjalë si */ctafe* (*shtasë*), *tr8efe* (*tryesë*), *parrijsi* (*parriisi*). Në standardin e sotëm këto fjalë shqiptohen me një *z*, por sipas Bashkimit ato përmbajnë një bashkëtingëllore të shurdhët në gegërishten.

Në supozojmë se në fjalët e huaja si *dio cefit* 126.16, *diocefiz8t* 128.9-10 (*dioçezit*, *dioçezit* syt), *di/gratiet* 185.24 (*dizgraciet*), shqiptohet një fishkëlluese e zëshme, meqenëse fjalët gjegjëse italishte *diocesi*, *disgrazia* shqiptohen me [z]. Huazimi turk *Paqarevet* 341.16 duhen lexuar *pazarevet*, khs. *Pazarevet* 90.9. Raste si *fëngire* 408.10, *fëngirit* 403.15 janë më të dyshimta –

fjalët turke *zincir*, *zencir* janë marrë nga gjuhë të ndryshme të Ballkanit me një s- nistore, dhe grafia e Budit me gjasë pasqyron një *senxhirë*²³.

Grafi të tilla si *exame* 272.3, *exempie* 69.27; 361.6 duken si latinizma. Por leximi mbetet i pasigurt. Budi shkruan edhe *ocaxione/cit* 231.9 dhe këtu një grafi latine është jashtë diskutimi. Ndoshta ato duhet të lexohen *ezamë*, *ezempie*, *okazioneshit*, khs. përgjegjësit italisht *esame*, *esempio*, *occasione*, të gjitha të shqiptuara me një tingull z të zëshëm.

Emri biblik *Ezechielit* 68.5, *Ezzechiellit* 334.29 etj. tani përgjithësisht shqiptohet *Ezekieli*. Leximi në SC gjithsesi mbetet i pasigurt; veçanërisht grafia zz mund të sugjerojë se ndoshta duhet lexuar *Ecekieli* (apo ndoshta *Exekieli*)²⁴.

Tingulli *sh* para një zanoreje të përparme shkruhet */c* (*sc*) sipas italishtes: */c*eculli (*shekulli*), *me/c*e (*meshë*), *ca/fc*e (*kafshë*), *me/c*erb8em (*me sherbyem*), */c*inte (*shinte*), *de/c*iyr (*dëshiir*), *inevo/c*imi (*i nevojshimi*) etj. Para zanoreve të prapme grafia është */ci*, edhe këtu sipas modelit italian: */c*iaam (*shaam*), */c*iochit (*shoqit*), */c*iuuom (*shukuom*), */c*iume (*shumë*) e të tjera.

Ndryshe nga italishtja, shqipja mund të ketë -*sh* në fund të fjalës dhe para një bashkëtingëlloreje; në këto raste Budi shkruan */c*: *chi/c* (*qish*), *ch8/c* (*qysh*), *cu/c* (*kush*), */c*ioff/c (*shofsh*), *mundime/c* (*mundimesh*), *temundgnie/c* (*të mundnjësh*), *ndemo/indyeksc* 219.16 (*ndë mos i ndjeksh*), – *oo/c*tupe (*oo shtupë*).

Grupi *shk* normalisht shkruhet */cc* (ose */ck*), por SC paraqet shembuj të ndryshëm të një */c* të thjeshtuar, p.sh. */c*ruom (*shkruom*), */c*on (*shkon*) e të tjera (po edhe */cc*ruom, */cc*on). Këto janë pas gjase vetëm lajthitje të rastit. Në shumicën dërmuese të rasteve ne gjejmë */c*andullizogn, */c*andullizim etj., por hasen edhe grafi si */cc*andullizogniene 57.21 e të tjera si kjo. Lat. *scandal(um)* është përshtatur herët si *shkandullë* (tani *shkandull*), ndërsa *skandal*, *skandaloz*, *skandalizoj* janë europianizma të rinj. Gegërishtja ka *shkannulloj*, *shkannulluer* (Bashkimi, 422), kështu që pas gjase ne duhet t'i lexojmë gjithmonë grafitë e Budit si *shkandull*-²⁵.

²³ Në rumanishten ka një *singir* ashtu si dhe në serbo-kroatishten e maqedonishten *sindžir*; bullgarishtja ka gjithashtu *sindžir*, por në dialekte gjendet edhe *zindžir*. Boretzky II, 145 jep trajtat e shqipes *zinxhir*, *zixhir* dhe (cituar nga Çetta dhe Meyer) *sinxhir*, *sixhir*, *sënxhir*. Sipas Becit 265, në Kurdari (rajoni i Matit) fjala përdoret në trajtën *saxhar*.

²⁴ Khs. grafitë *Zacharisse*, *Zebedeut* te Buzuku. Çabej mendon se ato duhen lexuar me një x- nistore; shih botimin e Buzukut, f. 58.

²⁵ Bardhi ka: */cc*andalum/*Scandule*, por natyrisht, drejtshkrimi i tij është larg së qeni i besueshëm. Fjala *shkandull* mungon nga lista e Haarmannit. – Mbi këtë leksemë e të tjera me ndërndërrimin *sk* ~ *shk*, *sp* ~ *shp*, *st* ~ *sht*, khs. Çabej, botimi i Buzukut, f. 86-7.

Tingulli *c* gjithmonë shkruhet *z* (ka dy variante tipografike; khs. më lart, f. 26): *teziatē caffce* 219.15 (*të ciatë kafshë*), *zemiterize* 121.8 (*cemiterit së*), *ekezegniene eluogniene* 96.30 (*e këcenjënë e luonjënë*), *chitemos ezegnyene* (*qi të mos ecënjënë*), *eharçuza* 317.19 (*e hardhuca*), *posicuummazamijne* 252.12 (*posikuur maca miinë, peze* 135.17 (*pecë*), *elenduom e malcuom*), *vert8tia eforza* 314.26 (*vertytja e forca*).

Shkronja *z* (e shqiptuar *c*) gjithmonë jep kombinimin që del kur një fjalë që mbaron me *-t* ndiqet nga një fjalë që fillon me *s-*: *diocefiz8t* 128.9-10 (*diocezit syt*), *hoostiete...* *duhene mechiene forte barça e grunize delire* 133.13-14, (*hoostietë...* *duhenë me qenë for-të bardha e grunit së dëlirë*), *languom fciochieniet emichiefiezenyereet* 273.16 (*languom shoqëniet e miqësiet së n'jerëzet*).

Kur nyja e përparme (konektive) së (në rrjedhore) nuk vjen menjëherë pas një *-t*-je, bashkohet rregullisht me një *n-* (parafjala origjinale) kështu: *ncë* (shkruar *nze*). Rrjedhoret e përemrave dëftorë dalin pa ndryshim *nzi* (*nci*), *nzo(ye)*, (*nco(je)*), *nzi/c* (*ncish*), *nzo/c* (*ncosh*). Budi gjithashtu përdor trajtat *kënci*, *acosh* etj.²⁶

Bashkëtingëllorja *ç* shkruhet sipas mënyrës italiane: *ncele* (*nçelë*), *melicentiet* 16.23 (*me liçenciet*), *vece* (*veçë*), *ncilete* (*nçiletë*), *egulcijt* 62.25 (*e gulçiiit “shqetësimet”*), *cias* (*čas*), *ncionete* (*nçonetë*).

Italishtja nuk ka [tʃ] përpara një bashkëtingëlloreje në pozicion fundor, ndërsa *ç* e shqipes është shumë e shpeshtë në këto pozicione. Në këto raste Budi shkruan *c*: *cmuom*, *cmim* (*çmuom*, *çmim*), *cmignie* (*Çminjë*), *pas* 225.18 (*paç < patsh*; dëshirore, v. 2 njëjës).

Në SC gjejmë një numër të madh shembujsh ku grupi *sht* është shndërruar në *çt*. Hasim vazhdimisht *puctet*, *puctogn* (*puçtet*, *puçtonj*) e të tjera si këto, si edhe *scatiepocet* [5.13] (*shtie poçtë*), *ctruom*, *ctrogniene* (*çtruom*, *çtronjënë*), *mectrijm*, *meuctrim* (*me çtriim*, *me u çtrim*) e kështu me radhë. Fjala *shpejt* në SC është: *cpeyt* (*çpejt*).

Përpara një bashkëtingëlloreje të shurdhët parashtesa privative është gjithnjë *ç-*: *emeccarcuom* 222.30 (*e me çkarkuom*), *eckermen8em* (*çkërmënyem*), *eckrini* 322.31 (*e çkrini*), *icculle* 163.14, *eccule* 163.18 (*i çkuli*, *e çkulë*), *eccufcellohen* 148.2 (*e çkushëllohenë*; khs. *engufcellonene* 147.4 e *ngushëllonenë*), *cpbleem* etj. (*çpërbleem*), *cpiha* 105.18, 106.20, *cpihune* 137.31 (*çpiha*, *çpihunë*), *ecporrune* 163.21 (*e çporrunë*; *eti cporranie* 163.6 është një gabim shtypi për: *e t i çporrë rranjë*), *cpri/ciune* (*çprishunë*; e

²⁶ Në gegërishten qendrore gjendet rregullisht *c* në vend të *s* në një numër të kufizuar leksemash, ndër të tjera te dëftorët. Khs. Gjinari, f. 54. Shembuj gjenden edhe në tekstet e Papa Totasit dhe Dhaskal Todhrit nga Elbasani: *prej këco gjinvet, një acish*, – *prej acish* (Shuteriqi, 1955, f. 55, 57, 60).

shpeshtë), *ckitune* 142.1 (*çqitunë*), *ck8retim*, *ck8retun* e të tjera si këto (*çqyrëtim*, *çqyrëturn*).

Budi pati vështirësitë më të mëdha për të caktuar një rregull drejtshkrimor për tingujt *x*, *xh*, *zh*.

Modeli i italishtes e pajisi autorin me *z* për *x* p.sh. në *nzane* (*nxxanë*), *mezane* 96.12 (*me xanë*), *inzeete* (*i nxeetë*), *nzierre*, *nzuor* (*nxjerrë*, *nxuor*), *nzit* (*nxit*). Te *spenzuom*, *spenzime* e të tjera si kjo mund të na duhet të lexojmë *spenxuom*, *spenxime* (khs. Bashkimi, 403) – ose ndoshta edhe *scandullizim* (*shkandullixim*) dhe *martirizuō* 15.11 (*martirixuom*).

Folja e përfaqësuar nga *estizuom* 58.21, *emestizuom* 60.12, *eestizogniene* 5.4 nuk është krejt e qartë. Duke gjykuar nga konteksti duket se do të thotë “*nxis*; shtyj” a diçka të tillë. Në qoftë se kjo është e saktë, mund të jetë një huazim nga serbokroatishtja: (*pod*) *sticati*, dhe në këtë rast duhet lexuar *sticonj*.

Si *zh* ashtu dhe *xh* janë tinguj relativisht jo të shpeshtë, dhe në bazë të SC është e vështirë të japësh një tablo të saktë të drejtshkrimit të tyre – nëse vërtet Budi përdori ndonjë normë të qëndrueshme.

Një *zh*-nistore ka në fjalët *xapign* 317.19 (*zhapinj*), *xapignte* 318.6 (*zhapinjte*) dhe në *x8em* 12.14 (*zhyem*). Budi e ka përdorur këtë grafi edhe gjetkë: në DC 193 b 15 dhe 223 b 19 ai ka *X8em* si në SC, por në DC 179 b 15 bashkëtingëllorja jepet me anë të një asterisku: **8em*²⁷.

Grupi *zhd* jepet si *fcd* në *gozhd*: *megofcdet* 240.28, *emegofcdet*... *igofcduone* 210.20-21. Fjalët *ndegraxttecaut* 265.9, që përfaqësojnë një shqiptim *ndë grash-të kaut*, me gjasë nga *ndë grazhd* të *kaut* (lokativ), i përkasin fjalës *grazhd*. Budi shkruan pa ndryshim *chifcdo* (*qishdo*), me gjasë shqiptohet *qizhdo*.

Ka një *xh*-nistore në fjalën *xhudhii* “çifut”, që është shumë e shpeshtë në SC. Thuajse gjithmonë shkruhet *giužij*, pa dyshim një imitim i italishtes *giudeo*, që i afrohet në shqiptim. Por gjejmë edhe grafi të rralla si *zužij* 386.17, *gniayzzužiu* 189.6²⁸

Budi përdor rregullisht parashtesën privative *ç*- para bashkëtingëlloreve të shurdhëta dhe që këtej ne mund të supozojmë se përdorej para bashkëtingëlloreve të zëshme opoziti *xh*-: *zbulogn*, *zbut* (*xhbulonj*, *xhbut*). Në shumicën e rasteve SC ka: *zgiež*, *zgiçune* e të tjera (*xhgjedh*, *xhgjidhunë*) – por *zzgieže* 152.10 dhe *tezagieže* 24.29, *zagiçune* 3.16 (gabime shtypi?). Krahas *i çkathëtë* gjejmë: *etezgažçete* 340.22 (*e të xhgathëtë*).

²⁷ Kjo mënyrë shkrimi ka qenë ndoshta një përpjekje për të imituar shkronjën ж të alfabetit cirilik.

²⁸ Grafia *z* është përdorur edhe në Dictionarium-in e Bardhit: *Iudæus*, *Giudeo/Zužçij*, khs. *Jchonobates/Ai ghi luen tue ezune, zambaē* (nga turqishtja *cambaz* “akrobat në shpinë të kalit; zbutës kuajsh”), *figillum/Scizil* (*shixhil*).

Bashkëtingëlloret e shurdhëta: të zëshme që shkruhen *q : gj* në drejtshkrimin e sotëm të shqipes kanë një shqiptim që ndryshon mjaft përgjatë hapësirës gjuhësore. Gjuha standarde rekomandon një shqiptim gutural palatal (grykor qiellëzor): [k] : [ǵ]. Kjo do të thotë që kemi të bëjmë me bashkëtingëllore të tipit që në shumë gjuhë janë thjesht variante të bashkëtingëlloreve të zakonshme *k : g* në pozicione ku ndiqen nga zanore të përparme. Por në shqipe *q : gj* dalin edhe para zanoreve të prapme si dhe në pozicione fundore ose para bashkëtingëlloreve; nga ana tjetër tingujt e shqipes *k : g* dalin edhe në pozicione ku ndiqen nga zanore të përparme pa ndonjë palatalizim të rëndësishëm nga ana fonetike²⁹.

Shqiptimi standard i *q : gj* i përgjigjet asaj që mund të quhet norma e toskërishtes. Lëkundje të konsiderueshme në shqiptimin e këtij çifti bashkëtingëlloresh janë karakteristike sidomos për pjesën gege të territorit gjuhësor. Foneticienët dhe dialektologët janë në një mendje kur përshkruajnë *q : gj* si bashkëtingëllore që shoqërohen nga një dozë zhurme fërkimore, kështu që ato marrin njëfarë shqiptimi të afrikuar³⁰. Nga hulumtimet dialektologjike të disponueshme del se afrikimi i *q : gj* vjen duke u shtuar sa më shumë lëvizim drejt veriut në truall të gegërishtes. Në të njëjtën kohë në rajonet e gegërishtes veriore (dhe lindore) nyjëtimi shtyhet aq shumë përpara në gojë sa që këto bashkëtingëllore shndërrohen në afrikate dentale (dento-palatale). Tingujt duket se ndryshojnë shumë nga një vend në tjetrin dhe si dialektologët vendas ashtu dhe studiuesit e huaj përdorin shenjime të ndryshme: *tś- : dž, ć : xh* e kështu me radhë³¹.

Është fakt i mirënjohur se grupet bashkëtingëllore origjinale *kl, gl* të shqipes sot ruhen vetëm në të folmet arkaike të toskërishtes. Por në shekullin XVI ato ruheshin edhe në gegërishte, të paktën në dialektin e folur nga Buzukut në periferinë veriperëndimore. Jashtë kësaj, në gegërishten veriperëndimore (p.sh. në Shkodër) këto grupe u zhvilluan në *kj, g'j* (ndonjëherë të shkruara *ki, gi*) dhe kështu dalloheshin nga *q : gj*. Në pjesën kryesore të hapësirës gjuhësore, siç e dimë nga gjendja e sotme, gjithsesi, grupet origjinale *kl, gl* kanë rënë plotësisht në emërues të përbashkët me *q : gj* dhe ndajnë mënyrat e

²⁹ Për një përshkrim fonetik të detajuar të *q : gj* shih Dodi, 36-38.

³⁰ Khs. vërejtjet e Becit lidhur me të folmen e Matit, f. 253-4.

³¹ Mua më duken *q : gj* që kam dëgjuar në Shkodër ose në disa vise në Kosovë si pak a shumë identike me çiftin dento-palatal të serbo-kroatishtes *ć : đ*. Vëzhgimet e dialektologëve lidhur me mënyrat e ndryshme të shqiptimit të bashkëtingëlloreve shqipe *q : gj* mund të përmbliidhen lehtë me një vështrim te Desnickaja 1968. Është interesante të vërejmë se si dallimi i shqipes midis shqiptimit të *q : gj* si guturale palatale në jug por si afrikate dentale në veri ndiqet nga një dallim i ngjashëm midis dy llojeve të shqiptimit të *k : g* në maqedonisht. Khs. Koneski, f. 69-75.

ndryshme të shqiptimit karakteristike për këto bashkëtingëllore në të folmet e ndryshme lokale.

Është e rëndësishme t'i kemi parasysh të gjitha këto kur studiojmë *q* : *gj* në gjuhën e Budit dhe përpiqemi të kuptojmë drejtshkrimin e tij. Në këtë pikë të veçantë, gjithashtu, ashtu si gjetiu, ai e mbështeti drejtshkrimin e tij në modelin e italishtes, dhe për këtë arsye tabloja është kaq e paqartë dhe madje kontradiktore.

Për *q*, SC shkruan rregullisht *ch* para *i*: *chifc* (*qish*), *fciochit* (*shoqit*) – dhe para *y*: *ch8fc* (*qysh*), *pelch8em* (*pëlqyem*) – si dhe në fund të fjalës: *anemich* (*anëmiq*), *pach* (*paq*) (*kekh* 228.23 për *keq* është gabim shtypi i rastësishëm) – dhe para një bashkëtingëllores: *tekechte* (*tëkeqtë*), *turchte* 30.28 (*turqtë*), *eytukechm* 61.12 e *j* *tukeqm*). Para *ë* dhe *e* Budi si rregull ka *chi*: *achie* (*aqë*), *fciochienij* (*shoqënij*), *chiertuom* (*qërtuom*), *chie(e)llune* (*qe(e)llunë*), *uchiet* (*uqet*), megjithëse mund të haset edhe *chy*: *chye* (*qe*), *V chyet* [5.8] (*uqet*), *chylbefine* 380.9 (*qelbësinë*) e të tjera. Para zanoreve të prapme kemi vërejtur vetëm *chi*: *chiafe* (*qafë*), *nderechiune* (*ndërequnë*) (*kenahciune* 388.5-6 është një gabim shtypi i parëndësishëm).

Duke marrë parasysh modelin italian të drejtshkrimit të Budit, zgjedhja e tij për *ch* sugjeron një tingull të ngjashëm me *k*. Për më tepër, përdorimi nga ana e tij i *chie*, *chia*, *chiu* duket të tregojë se ai e shqiptonte një gutural palatal të llojit që njohim sot në shumicën e të folmeve. Pas gjase ajo ishte shumë afër italishtes *chi* p.sh. në *chiesa*, *chiaro*, *chiuso*.

Për *gj*, SC përdor rregullisht *g* para *i* dhe *y*: *giççe* (*gjithë*), *mengij* (*mëngjij*), – *g88ch* (*gjyyq*), *g8mpt8re* (*gjymptyre*); gjithashtu në fund të fjalës dhe para bashkëtingëlloresve ajo jepet si *g*: *lig* (*ligj*), *dog* (*dogj*), *ligfe* (*ligjë*). Përpara *e* dhe *ë* Budi zakonisht shkruan *gi*: *angienuum* (*angjënuom*), *giegiune* (*gjegjunë*), *lagie* (*lagje*); por ndeshen edhe raste si *geçç* 387.29 (*gjeth*), *egerbee*, *egerbeeya* 227.4, 6 (*zqjerbe* “molë”)³². Përpara zanoreve të prapme gjejmë vetëm *gi*: *giaa* (*gjaa*), *giak* (*gjak*), *giegiune* (*gjegjunë*).

Veçanërisht në këtë pikë neve na duket se drejtshkrimi i Budit është kontradiktor. Sipas rregullave të shqiptimit të vlefshme për italishten, kjo mënyrë shkrimi do ta përcaktonte *gj*-në sikur shqiptohet si afrikate dento-palatale: fjalë të italishtes si *giro*, *giuro*, *giallo* shqiptohen me një tingull afrikat që ndryshon nga [dž] deri në [dʒ]. Kjo do të thotë se këtu ne përballemi me një situatë të veçantë. Drejtshkrimi i SC sugjeron se *q* ka qenë një gutural palatal (shkalla e afrikimit të mundshëm nuk mund të vërtetohet), – por në të njëjtën kohë sugjeron se opoziti i zëshëm *gj* ka qenë një afrikat dental. Mirëpo kjo duket të jetë e pakonceptueshme sepse *q* dhe *gj*, për gjithë sa dimë, nyjëtohen gjithmonë në mënyrë ekzakte paralele. Prandaj sa i përket leximit dhe transkriptimit ne nuk shohim alternativë tjetër veçse t'i mbajmë *q* e *gj* aty ku

³² Ndoshta duhet lexuar *zgerbe*; khs. vërejtjet etimologjike të Çabejt.

duhet në bazë të standardeve të sotme dhe ta lëmë të hapur çështjen e vlerës së tyre të saktë fonetike.

Prapëseprapë, ne nuk e fshehim mendimin tonë që zgjedhja e Budit për *ch(i)* në vend të *c(i)* siç u përmend më lart flet për një shqiptim [k'] (më shumë se [ć]). Dhe zgjedhjen e tij të *gie* (në vend të *ge*) ne priremi ta interpretojmë në mënyrë të ngjashme. Pas gjase shqiptimi i Budit ka qenë [ǵ], dhe zor të ketë qenë afrikatja e thjeshtë dento-palatale të cilën do ta sugjeronte *ge*-ja, sipas rregullave të italishtes. Megjithatë ne pranojmë se e gjitha kjo mbetet një supozim i pastër, dhe është e vështirë të gjenden argumente më bindëse dhe përfundimtare. Gjithsesi, është e çuditshme që Budi nuk zgjodhi *gh* si opozitin e zëshëm të *ch*.

Në një pikë tjetër gjuha e Budit është krejt e qartë: në leksemat që në shqipen e përgjithshme përmbanin *kl*, *gl* këto grupe bashkëtingëlloresh janë braktisur krejt në të mirë të tingujve që shkruhen në të njëjtën mënyrë si *q* : *gj*: *chiaam* (*qaam*), *chie*, *chiene*, *chiofte* (*qe*, *qenë*, *qoftë*), – *giugnie* (*gjunjë*), *ndegionete* (*ndëgjonetë*), *giuhu* (*gjuhu*), *giumezij* (*gjumëcij*) e të tjera. Në pikëpamjen tonë kjo rrethanë pas gjithë gjasash mund të merret si një tjetër tregues që *q* : *gj* janë nyjëtuar si guturale palatale në gjuhën e Budit. Arsyeja për këtë është se në ato dialekte ku *kl*, *gl* mbijetojnë si grupet *kj*, *g'j* dhe kështu dallohen nga *q* : *gj*, këto të fundit janë afrikate dento-palatale. Përderisa *kl* (*kj*), *gl* (*g'j*) nuk dallohen nga *q* : *gj* në SC, ne nuk shohim arsye për të besuar se *q* : *gj* të Budit nuk ishin guturale palatale. Nëse kjo është e drejtë, tregon se gjuha e pasqyruar në SC ishte në fakt një varietet jugor i gegërishtes. Natyrisht, kjo nuk është për t'u çuditur, meqenëse autori rridhte prej Gurit të Bardhë.

Budi ka *k* në fjalët *king* (*kingj*) (*qingj*) dhe *kifce* (*kishë*, në të folme *qishë*).

X.

Në këtë paragraf përmyllës do të përpiqemi të përmbledhim gjetjet kryesore të analizës sonë dhe të japim disa udhëzime se si të lexojmë veprën e Budit *Speculum Confessionis* të vitit 1621. Shkronjat e alfabetit të përdorura në libër do të ndahen në tri grupe.

Grupi i parë përfshin të gjitha shkronjat që mund të interpretohen vetëm në një mënyrë, dmth. shkronja me vlerë fonetike të qëndrueshme. Ato nuk nxjerrin probleme kur duhet lexuar teksti dhe mund të transkriptohen direkt sipas parimeve të sotme. Në këtë grup shkronjash hyjnë zanoret *a*, *o* dhe *8* (= *y*), të cilat mund të jenë të shkurtra si edhe të gjata (të shkruara dyfish). Në të njëjtin grup hyn *ξ* (= *dh*) dhe e dyfishta *ξξ* (= *th*), e cila përbën një çift bashkëtingëlloresh e shurdhët : e zëshme. Çifte të ngjashme të zëshme : të shurdhëta janë *b* : *p* dhe *d* : *t*; secila prej tyre pranon vetëm një interpretim. Më në fund, në grupin e parë të shkronjave kemi *ε* (= *z*), *f* dhe dy hundoret *m* dhe *n*.

Një numër shkronjash në alfabetin e Budit kanë si rregull dy vlera tingullore secila, dhe këto shenja përbëjnë *grupin e dytë* të alfabetit. Për të

lehtësuar një lexim të saktë të tekstit është e nevojshme në këtë rast të bëjmë krahasime me gjendjen e gjuhës siç e njohim sot dhe të marrim parasysh kontekstin e ngushtë grafik të shkronjave në fjalë.

Shkronja zanore *e* ka vlerat *e* dhe *ē*, dhe përndarja e tyre natyrisht duhet vendosur në përputhje me njohuritë tona për përndarjen e tyre në gjuhën e sotme. Gjegjësja e saj, *ee* dyfishe, zakonisht duhet kuptuar si *ē* e gjatë; ne ndërkaq kemi shpjeguar arsyet tona për ruajtjen e drejtshkrimit të Budit *ee* në transkriptim. Përveç kësaj, ne kemi vërtetuar se del të ketë qenë synimi i autorit që të tregojë një *ē* me anë të grafisë *ee*.

Sa për shkronjat *j* dhe *y*, e para gjendet vetëm në kombinimin *ij*, dhe kjo në parim ka kuptimin *ī* dhe duhet transkriptuar *ii*. Shkronja *y* është shenja e Budit për bashkëtingëlloren *j*. Në të njëjtën kohë *y* tregon gjysmëzanoren *j* që del nga diftongimi; ne parapëlqejmë ta riprodhojmë atë me *j*, sepse kjo në fakt i afrohet më shumë interpretimit të vetë Budit të këtij tingulli të veçantë.

Që të dyja, *u* dhe *v* kanë një vlerë tingullore zanore po aq sa dhe bashkëtingëllore, dhe në secilin rast duhet vendosur përmes një krahasimi me gjuhën e sotme kur na duhet të përdorim zanoren *u* apo bashkëtingëlloren *v* në lexim dhe transkriptim. Në shumicën dërmuese të rasteve këto shkronja nuk paraqesin problem, sepse Budi natyrisht synonte një përndarje në përputhje me normat që i njohim nga standardi i sotëm. Sido që të jetë, në SC ka ende gjurmë të praktikës së mëhershme tipografike tradicionale sipas së cilës shkronja *v* duhej përdorur në fillim të fjalës ndërsa shkronja *u* në trup të fjalës pa marrë parasysh vlerën e tyre fonetike reale. Shkronja *uu* dyfishe tregon një tingull të gjatë *u* dhe duhet ruajtur në transkriptim. Një *vv* dyfishe nuk del në SC.

Shkronja *h* përgjithësisht duhet lexuar e transkriptuar si *h*. Ndërsa kombinimi *ch* i përgjigjet së sotmes *q* (në disa fjalë të huaja mund të lexohet edhe *k*). Grupi *chie* përmban një *i* diakritike që nuk shqiptohet: *qe*, *qē*; ai përdoret edhe para zanoreve të prapme: *chia* = *qa*, *chio* = *qo*, *chiu* = *qu*.

Shkronjat *l* e *r* në vetvete nuk shkaktjnë problem për leximin. Por Budi shpesh i dyfishon ato, dhe kur kjo ndodh, duhet krahasuar me praktikën e sotme drejtshkrimore dhe të autorëve të tjerë të vjetër në mënyrë që të vendosim në secilin rast nëse *ll* dhe *rr* tregojnë tingujt që sot shkruhen kështu. Duket se Budi vërtet kishte qëllim të dallonte *l* : *ll*, *r* : *rr*; por ai nuk arriti ta mbajë këtë parim drejtshkrimor me rregullsi, kështu që në këtë pikë grafia e tij duhet shqyrtuar me vëmendje të veçantë.

Më në fund, në këtë grup shkronjash ne gjejmë edhe *k*, të cilën Budi e përdor shumë shpesh edhe pse është shumë e pazakonshme në praktikën drejtshkrimore italiano-latine. Me *k* autori zakonisht shënon tingullin *k*, më tepër në kombinimet *ke* = *ke*, *kē*, *k8* = *ky*, dhe *ki*. Megjithatë, kombinimi *ck* në disa raste duhet lexuar *çq*: *cki* = *çqi*, *ck8* = *çqy*.

Grupi *i tretë* i shkronjave kërkon vëmendjen më të madhe kur është fjala për leximin dhe transkriptimin, sepse shenjat që hyjnë në këtë grup përdoren

me vlara të ndryshme tingullore që ndryshojnë sipas kombinimeve në të cilat hasen.

Shkronja *i* mund të tregojë zanoren *i* por vetëm versionin e shkurtër, ndërsa *ii* e gjatë gjegjëse (*ī*) në SC shkruhet *ij*. Kombinimi *ie* mund të tregojë grupin zanor *ie* ose diftongun ngjithës *je*; përndarja e këtyre të dyjave ngre disa probleme që nuk mund të zgjidhen përfundimisht derisa të kryhet një analizë e plotë e gjithë materialit gjuhësor dhe të bëhen përqasje me përdorimin e shekullit XVII dhe të dialekteve të sotme. Budi mjaft shpesh përdor shkronjën *i* për të treguar bashkëtingëlloren *j*, e cila përgjithësisht shkruhet *y*. Më në fund, në disa kombinime shkronja *i* është thjesht një shenjë diakritike pa ndonjë vlerë fonetike të vetën.

Shkronja *x* është e rrallë në SC, prandaj është e vështirë të vërtetohen vlerat e sakta fonetike të saj. Mund t'i përgjigjet vlerës fonetike *ks*, por në disa shembuj ajo përdoret si *zh*-ja e standardit të sotëm.

Nga ana tjetër, shkronja *z* është tejet e shpeshtë në SC. Përgjithësisht ajo ka vlerën fonetike të *c*-së (ose, në të vërtetë, *-t + s-*), por në disa leksema është mënyra e Budit për të identifikuar afrikatën e zëshme gjegjëse *x*; përndarja duhet bërë në bazë të përdorimit të sotëm gjuhësor. Më në fund, lexuesi duhet të mbajë parasysh se *z* (në raste të rralla *zz*) del se shënon afrikatën *xh* (kryesisht si parashtesë privative).

Shkronjat *f* dhe *s* janë thjesht variante tipografike që shënojnë të njëjtin tingull: *s*; por ekziston mundësia që ajo ndonjëherë të shqiptohet *z*, të paktën në disa leksema me prejardhje të huaj. Kombinimi *fc* është treguesi i zakonshëm për bashkëtingëlloren *sh*. Ai përdoret në pozicione fundore, para bashkëtingëlloreve dhe zanoreve të përparme: *fce = she, shë, fci = shi* (një *fc8 = shy* nuk është vërejtur). Përpara zanoreve të prapme shtohet një *i* diakritike pa vlerë tingullore: *fciā = sha, fcio = sho, fciu = shu*. Kombinime të shpeshta me këtë shkronjë janë: *fcc* (rrallë *fck*) = *shk, fch(i) = shq, fcp = shp* dhe *fct = sht*. Në raste të veçuara gjejmë *fcd = zhd*.

Shkronja *c* gjithmonë ka vlerën fonetike *k* në kontakt me zanoret e prapme: *ca = ka, co = ko, cu = ku*; para zanoreve të përparme *c* shënon *ç*: *ci = çī, ce = çe (çë)*. E ndjekur nga një *i* diakritike, e cila nuk shqiptohet, gjejmë grafitë *ciā = ça, cio = ço, ciu = çu*. Përpara bashkëtingëlloreve dhe në pozicione fundore, *c* përgjithësisht shënon *k*, por edhe një *ç* mund të shënohet në këtë mënyrë. Shkronja *c* gjendet në kombinime të ndryshme bashkëtingëlloresh. Përveç *fc* (= *sh*) që e përmendëm më lart, një vëmendje e veçantë u duhet kushtuar atyre rasteve në të cilat *c = ç* është parashtesa privative, si *cc = çk, ck = çq, cm = çm, cp = çp* etj. Për grupin e shkronjave *ch*, khs. më lart, f. 31.

Shkronja *g* gjithnjë ka vlerën fonetike *g* përpara zanoreve të prapme: *ga, go, gu*. Para zanoreve të përparme ka dy lexime me *gi = gi* ose *gji, ge = ge, gë* dhe *gje, gjë*, zgjedhja duhet bërë në bazë të krahasimit me përdorimin e sotëm.

Kombinimi *g8* është gjithmonë *gjy*. E ndjekur nga një *i* diakritike: *gia* = *gja*, *gio* = *gjo*, *giu* = *gju*. Para bashkëtingëlloreve si dhe në fund të fjalës, *g* është më tepër një tregues i bashkëtingëllores *g*, por edhe tingulli *gj* mund të përfaqësohet në këtë mënyrë. Ka vetëm një grup bashkëtingëlloresh që përmban këtë shkronjë dhe që del rregullisht: *gn* = *nj*. Ai shpesh shtohet me një *i* diakritike para zanoreve të prapme: *gnia* = *nja*, *gnio* = *njo*, kurse *gnie* dhe *gne* = *nje*, *një* hasen të dyja.

Kjo rikujtesë e paragrafëve të mëparshëm të artikullit tonë natyrisht nuk është aspak shteruese; qëllimi ishte vetëm të mblidhnim së bashku disa çështje kryesore. Megjithatë, ne e ndiejmë se tabloja jonë sinoptike përfshin parimet kryesore drejtshkrimore të SC. Ne besojmë se në bazë të këtyre parimeve do të jetë e mundur të lexohet libri me një shkallë të mirë sigurie. Më së fundi, ne besojmë se, duke përdorur vërejtjet tona si pikënisje, do të jetë e mundur madje të ndërmerret edhe një transkriptim i librit të Budit. Dhe ky është vërtet një *desideratum* albanologjik.

Nga çfarë dimë deri tani për gjuhën e Budit (khs. bibliografinë), mund të supozojmë qysh tani se hulumtime të mëtejshme dhe më të kujdesshme do të nxjerrin material të rëndësishëm që mund të hedhë dritë në disa aspekte të gjuhës shqipe në të kaluarën dhe të tashmen. Sistemi fonetik siç pasqyrohet në SC dhe në veprat e tjera të autorit ka tërhequr tashmë vëmendjen e studiuesve në lidhje me studimin e Buzukut dhe shkrimtarëve të tjerë të vjetër; dhe ai tashmë luan një rol të rëndësishëm në përshkrimin e historisë së gjuhës. Nuk ka dyshim se gjuha e Budit është e aftë të zbulojë një numër të mirë të fshehtash fonetike. Vëzhgime të vlefshme morfologjike janë ndërmarrë gjithashtu nga gjuha e Budit dhe ato janë diskutuar në monografi dhe artikuj. Mirëpo, neve na mungon ende një tablo gjithëpërfshirëse e gjuhës së Budit si e tillë. Ne pranojmë se është e mundur dhe madje ka shumë gjasë që një i huaj, që nuk e ka shqipen gjuhë amtare, e ndien këtë nevojë më fort se një folës nativ. Megjithatë, ne marrim guximin të sugjerojmë disa probleme morfologjike që sipas mendimit tonë duhen hetuar në imtësi mbi bazën e një shqyrtimi të kujdesshëm të gjuhës së Budit: përftimi i temave të shumësit dhe eptimet e rasave të emrave në trajtat e tyre të pashquara e të shquara dhe në lidhje me këtë, një paraqitje të plotë tabelare të tipave të ndryshëm të asnjansëve; një paraqitje shteruese e përemrave pronorë intrigues, tipat e zgjedhimit dhe infleksionet e tyre. Lidhur me një studim mbi sintaksën e Budit, do të ishte e dëshirueshme të kishim një tablo të detajuar të përdorimit të njeve, të mënyrave dhe kohëve të foljeve, si dhe të disa dukurive ballkanike të tilla si “dyfishimi i kundrinës” apo të “admirativit” mbeturinor. Më në fund, formimi dhe përdorimi i lidhëzave është ende një fushë e lënë pas dore e kërkimeve ballkanologjike. Fjalori i Budit ende pret një hetim të hollësishëm, i cili mund të zbulojë jo vetëm arkaizma të rralla (dhe ndoshta neologjizma) por edhe të

hedhë dritë mbi shtresat kronologjike të lëndës së huaj: huazimeve turke, sllave, greke, romane dhe latine.

Në frontespicin shqip të SC na thuhet se *Pasëqyra e t Rrëfyemit* është një përkthim i librit të Emerio de Bonis *Specchio di Confessione*. Ky cilësim i librit është në fakt tepër modest. Kjo sepse, nëse e krahasojmë me botimin italisht të librit të de Bonisit të vitit 1611, bëhet shpejt e qartë se Budi përqafoi të njëjtën qasje (me atë të de Bonisit) vetëm pjesërisht dhe ndoqi të njëjtën linjë mendimi vetëm në terma të përgjithshëm. Është vështirë të flasësh për një përkthim në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Do të ishte më e përshtatshme ta quanim SC një përshtatje të lirë, të plotësuar me shtesa të gjera; në këtë mënyrë libri i Budit, i parë në tërësi, mund të karakterizohet si vepër origjinale. Për më tepër, autori është një stilist i shkëlqyer dhe fjalitë e tij kanë sa qartësi aq edhe elegancë. Ai shprehet pa shtrëngesë e vështirësi, dhe gjithë kjo tregon se gjuha e tij meriton të hulumtohet jo thjesht për përdorimin e idiomave. E përmendim këtë sepse përdorimi i gjuhës dhe sidomos frazeologjia – siç ka theksuar Sandfeldi më se gjysmë shekulli më parë – janë në fakt një pjesë vitale e atij sistemi tiparësh të përbashkëta që bashkojnë gjuhët e Europës juglindore në një *Sprachbund*.

Kështu gjuha e Budit nuk është vetëm çështje e albanologjisë. Ajo i përket ballkanologjisë në tërësi.

BIBLIOGRAFI

- Ashta, K., “Rreth disa çështjeve të leksikut të Pjetër Budit” (*Studime filologjike XX (III)*); Tiranë 1966.
- Beci, B., “Hulumtime gjuhësore në Mat” (*Buletin i Shkencave Shoqërore XVI. 2, XVII. 2-3*); Tiranë 1962-3.
- Bardhi, *Dictionarium latino-epiroticum... per Franciscum Blanchum*; Romæ 1635.
- Bogdani, *Cuneus Prophetarum de Christo, Salvatore mundi, et ejus evangelica veritate... contexta... a Pietro Bogdano; I-II*; Patavii 1685.
- Boretzky, Norbert, *Der türkische Einfluss auf das Albanische*, 1-2; Wiesbaden 1975-6 (*Albanische Forschungen*, 11-12).
- Budi, *Speculum Confessionis in epyroticam linguam a Pietro Budi, episcopo Sapatense et Sardanense translatum*; Romæ 1621.
- Cipo, K., *Gramatika shqipe*; Tiranë, 1949.
- Çabej, E., “Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes” (*Buletin i Shkencave Shoqërore 1957. 2*). Shih edhe: *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*; Tiranë 1973.
- Çabej, E., “Diftongje e grupe zanoresh të shqipes” (*Buletin i Shkencave Shoqërore 1958. 3*). Shih edhe: *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*; Tiranë 1973.

- Çabej, E., “Tekstet e vjetra shqip dhe disa kriteret rreth botimit të tyre” (*Buletin i Shkencave Shoqërore* 1959. 2). Shih edhe: *Studime gjuhësore*, VI; Prishtinë 1977.
- Çabej, E., “Pjetër Budi dhe gjuha e tij” (*Studime filologjike XX (III)*. 4); Tiranë 1966. Shih edhe: *Studime gjuhësore*, VI; Prishtinë 1977.
- Çabej, E., (red.), “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555). *Botim kritik, I-II*; Tiranë 1968.
- Çabej, E., “Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike” (*Studime filologjike XXIV*. 4); Tiranë 1970. Shih edhe: *Studime gjuhësore*, VI; Prishtinë 1977.
- Çabej, E., “Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe” (*Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*; Tiranë 1973¹. Botuar së pari në rumanisht në: *Studii și cercetări lingvistice*, X. 4; București 1959.
- Çabej, E., “Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe” (*Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*; Tiranë 1973². Botuar së pari në *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës; seria Shkencat Shoqërore*, 1958. 1.
- Çabej, E., “Studime etimologjike në fushë të shqipes” (*Studime gjuhësore, I-II*); Prishtinë 1976¹.
- Çabej, E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes, II (A-B)*; Tiranë 1976². Shih edhe: *Studime gjuhësore*, I; Prishtinë 1976.
- Çabej, E., “Fonetika historike” (*Studime gjuhësore, III*); Prishtinë 1976³ (botuar së pari 1958).
- Demiraj, Sh., “Rreth formavet të së ardhmes në gjuhën shqipe”, (*Studime filologjike* 1970. 3). Shih edhe: *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*; Tiranë 1973.
- Demiraj, Sh., “Habitorja dhe mosha e saj” (*Studime filologjike* 1971. 3). Shih edhe: *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*; Tiranë 1973.
- Demiraj, Sh., *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, 1-2; Tiranë 1973-6.
- Demiraj, Sh., *Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe*; Tiranë 1975.
- Dodi, A., *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*; Prishtinë 1970².
- Domi, M., “Pjetër Budi (1566-1622)” (*Studime filologjike XX (III)*. 4); Tiranë 1966.
- Fjalor i gjuhës shqipe* (red. K. Cipo); Tiranë 1954.
- Fjaluer i Rii i Shcypës*, perbaam préie Shocniiét t’Bashkimit (Fjalori i “Bashkimit”; ribotim, Prishtinë 1978²).
- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II: Morfologjia* (red. M. Domi, Sh. Demiraj); Tiranë 1976 [maket].
- Gjinari, J., *Dialektologjia shqiptare*; Prishtinë 1070².
- Haarmann, Harald, *Der lateinische Lehrwortschatz im Albanischen*; Hamburg 1972 (Hamburger philologische Studien, 19).
- Historia e letërsisë shqipe, I: Folklori shqiptar*. Letërsia e vjetër shqipe; Tiranë 1959.

- Jokl, N., “Zur Geschichte des alb. Diphthongs -ua-, -ue-” (*Indogermanische Forschungen*, 49-51); 1931-2.
- Конески, Блаже, Историја на македонскиот јазик; Скопје 1965.
- Kostallari, A. (red.), *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*; Tiranë 1973.
- Kostallari, A. (red.), *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*; Tiranë 1976.
- Kristoforidhi, K., *Fjalor shqip-greqisht*; Tiranë 1961 (botuar nga Aleksandër Xhuvani në transliterim nga botimi i parë, Athinë 1904).
- Lacaj, H., “Pjetër Budi, vjershëtor i pari i letërsisë sonë” (*Studime filologjike XX (III). 4*); Tiranë 1966.
- Mann, S. E., *An Albanian Historical Grammar*; Hamburg 1977.
- Meyer, G., *Kurzgefasste albanesische Grammatik*; Leipzig 1888.
- Pekmezi, G., *Grammatik der albanesischen Sprache (Laut- und Formenlehre)*; Wien 1908.
- Riza, S., *Studime albanistike, I*; Prishtinë 1979.
- Roques, M., *Le dictionnaire albanais de 1635*; Paris 1932².
- Roques, M., *Recherches sur les anciens textes albanais*; Paris 1932².
- Sandfeld, K., *Balkanfilologien. En oversigt over dens resultater og problemer*; Kobenhavn 1926.
- Sandfeld, K., *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*; Paris 1930.
- Schaller, H. W., *Die Balkansprachen. Eine Einführung in die Balkanphilologie*; Heidelberg 1975.
- Shkurtaj, Gj., “E folmja e Kelmendit” (*Dialektologjia shqiptare, III*); Tiranë 1975.
- Shuteriqi, Dh. S., *Antologji e letërsisë shqipe për shkollat e mesme*; Tiranë 1955.
- Shuteriqi, Dh. S., *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*; Tiranë 1976.
- Ulqini, K., “Disa vëzhgime mbi të folmen e Matit” (*Buletin i Shkencave Shoqërore*, XVI. 2); Tiranë 1961.
- Xhuvani, A., Çabej, E., “Parashtesat e gjuhës shqipe” (*Buletin për Shkencat Shoqërore*, 1956); Tiranë. – Rishtypur në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II*; Tiranë 1975, – dhe në Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore, III*; Prishtinë 1976.

Përktheu: **Anila Omari**